




RREPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM

---

# METODOLOGJIA E VLERESIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK



TIRANË 2017

**METODOLOGJIA PËR VLERËSIMIN E JASHTËM TË  
CILËSISË  
“PËR VEPRIMTARINË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË  
SEKTORIN PUBLIK”**

Kjo Metodologji u hartua nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm mbështetur në publikimin e PEMPAL IACOP <sup>1</sup>“Guidë për vlerësimin e cilësisë për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

**Tiranë, 2017**

---

<sup>1</sup> Rrjeti i Menaxhimit të Shpenzimeve Publike me përfaqësues të 23 vendeve të Evropës dhe Azisë Qendrore. Komuniteti i Praktikës së Auditimit të Brendshëm

## **PËRMBAJTJA**

<b>HYRJE .....</b>	<b>3</b>
<b>KAPITULLI 1 - PLANIFIKIMI.....</b>	<b>5</b>
<b>KAPITULLI 2 - PROCESI I VLERËSIMIT TË JASHTËM .....</b>	<b>6</b>
<b>KAPITULLI 3 - RAPORTIMI .....</b>	<b>19</b>
<b>KAPITULLI 4 - MONITORIMI I PROGRESIT .....</b>	<b>22</b>
<b>ANEKSI 1 - LISTAT VERIFIKUESE .....</b>	<b>23</b>
<b>ANEKSI 2 - LISTA E SHKURTIMEVE .....</b>	<b>74</b>

# HYRJE

## Qëllimi i metodologjisë

Metodologjia është hartuar për të përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen nga Struktura Përgjegjëse e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm dhe nga vlerësuesit e kualifikuar të pavarur nga jashtë organizatës, për vlerësimin e jashtëm të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, nëse kjo veprimtari audituese është kryer në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Pranuara dhe praktikat më të mira.

Metodologjia ofron mënyrën e programimit, analizimit të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare të veprimtarisë së njësisë së auditimit të brendshëm, raportimit dhe monitorimit të progresit, si komponentë të rëndësishëm të procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë.

Qëllimi kryesor i kryerjes së vlerësimit të jashtëm të cilësisë është sigurimi i respektimit dhe zbatimit në një nivel të lartë të standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm si dhe identifikimi i fushave që kërkojnë përmirësim në veprimtarinë e NJAB-së, në të cilën kryhet ky vlerësim.

Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm (SPHAB), është organi përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të veprimtarisë së njësisë të auditimit të brendshëm.

Metodologjia e vlerësimit të jashtëm të cilësisë nuk është një dokument i pandryshueshëm, në të ardhmen mund të shtohen ose mund të ndryshohen elementë të saj, në përputhje me ndryshimet në mjedisin ligjor dhe atë të standardeve të auditimit të brendshëm.

### ***Standardi 1312 – Vlerësimet e Jashtme***

***Vlerësimet e jashtme duhet të kryhen të paktën një herë në 5 vjet nga një vlerësues i kualifikuar dhe i pavarur ose nga një skuadër vlerësuesish nga jashtë organizatës. Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të diskutojë me bordin për:***

- ***Formën dhe shpeshtësinë e vlerësimeve të jashtme; dhe***
- ***Kualifikimet dhe pavarësinë e vlerësuesit ose skuadrës së vlerësuesve të jashtëm, duke përfshirë çdo konflikt të mundshëm interesi.***

Menaxhimi cilësor i veprimtarisë së njësisë së auditimit, për të siguruar respektim në nivel të lartë të ligjshmërisë (në fushën e auditimit të brendshëm) dhe standardeve ndërkombëtare të pranuar, mbështetet në konceptet e mëposhtme:

- ***Kontrolli i cilësisë***, që garanton se procedurat e sigurimit të cilësisë janë krijuar dhe zbatuar në veprimtarinë operationale të auditimit;

- **Monitorimi i cilësisë**, që përfaqëson rishikim të pavarur të auditimeve individuale për të siguruar se procedurat e vlerësimit të brendshëm të cilësisë veprojnë në mënyrë efektive dhe në përputhje me manualin e auditimit;
- **Sigurimi i cilësisë**, që përfaqëson vlerësim të jashtëm të pavarur të procedurave të kontrollit të cilësisë dhe monitorimit, të cilat janë vënë në zbatim.

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm të IIA-së përkufizojnë se "... çdo njësi e auditimit të brendshëm (NJAB) duhet të ketë një vlerësim të jashtëm të cilësisë, të paktën një herë në pesë vjet, nga një shqyrtues i kualifikuar i pavarur nga jashtë organizatës".

Vlerësimi i jashtëm dhe i pavarur i cilësisë paraqitet në formën e:

- Një rishikim të jashtëm; ose
- Një vlerësim të brendshëm me vlefshmëri të jashtme.

Rishikimi i jashtëm i cilësisë, kryhet me shërbim kontraktimi nga një vlerësues i kualifikuar i pavarur nga jashtë njësisë publike. Sipas standardit, drejtuesi i NJAB-së duhet të diskutojë me titullarin/ bordin ose Komitetin e Auditimit të Brendshëm lidhur me:

- Nevojën për vlerësime të jashtme më të shpeshta; dhe
- Kualifikimet dhe pavarësinë e rishikuesit të jashtëm, apo grupit të rishikimit, duke përfshirë çdo konflikt të mundshëm interesi.

Rishikuesi i pavarur ose grupi i rishikuesve duhet :

- Të mos kenë konflikt interesash real apo të dukshëm;
- Të mos jenë pjesë e organizatës që do të vlerësohet; dhe
- Të mos jenë nën varësinë e organizatës në të cilën bën pjesë njësia e auditimit të brendshëm.

Vlerësimi i brendshëm me vlefshmëri të jashtme, do të kryhet nga struktura përgjegjëse e harmonizimit për auditimin e brendshëm, e cila harton regjistrin e vlerësimit të NJAB-ve me qëllim:

- Hartimin e programit vjetor të veprimtarisë së SPHAB-së;
- Respektimin e frekuencës së vlerësimit të jashtëm të cilësisë (të paktën 1 herë në 5 vjet);
- Identifikimin e njësive të auditimit me problematikë të shtuar;
- Ndjekjen dhe monitorimin e progresit të njësive të auditimit.

Vlerësimet e jashtme që kryhen nga SPHAB, do të kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit të auditimit të brendshëm në shkallë vendi.

## KAPITULLI 1 – PLANIFIKIMI

Struktura përgjegjëse e harmonizimit për auditimin e brendshëm përgatit programin vjetor të vlerësimit të jashtëm të cilësisë:

- në bazë të frekuencës, të paktën një herë në 5 vjet;
- në bazë të një procesi të përzgjedhjes nga vlerësimi i riskut;
- në bazë të ankesave;
- në bazë të çështjeve të ngritura në media ose;
- me kërkesë të vetë njësive të auditimit të brendshëm.

Programi vjetor i vlerësimit të jashtëm të cilësisë duhet të pasqyrojë:

- Njësitet e auditimit të brendshëm subjekt vlerësimi;
- Vitin kur është kryer vlerësimi i jashtëm i fundit;
- Periudha e planifikuar për kryerjen e vlerësimit;
- Burimet (ditë/ njerëz) të përllogaritura për kryerjen e vlerësimit.

Struktura për harmonizimin e auditimit të brendshëm përditëson çdo vit regjistrin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë së NJAB-ve, në të cilin të përfshihen të dhëna, lidhur me:

- Numrin e subjekteve;
- Statusin organizativ të NJAB-së, brenda njësisë publike;
- Nivelin e riskut;
- Frekuencën e kryerjes së vlerësimeve të jashtme;
- Nivelin e kualifikimit të stafeve të NJAB-ve,
- Numrin e rekomandimeve të dhëna NJAB-ve për përmirësim;
- Vlerësimet e jashtme të kryera nga KLSH-ja, apo vlerësues të kualifikuar të pavarur jashtë njësisë;

Pasiguria në arritjen e objektivave dhe në përmbushjen e misionit të veprimtarisë së njësisë së auditimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, konsiderohet risk për NJAB- në.

Përcaktimi i nivelit të riskut analizohet nëpërmjet faktorëve që lidhen me:

- ndryshimin e shpeshtë të stafit të audituesve dhe përfshirjen në NJAB të specialistëve të pakualifikuar;
- ndryshimin e shpeshtë të drejtuesve të NJAB;
- problematikat e identifikuara nga vlerësimet e mëparshme; dhe
- kompleksitetin dhe madhësinë e njësisë publike, pjesë e të cilës është NJAB.

Niveli i riskut të vlerësuar sipas faktorëve të analizuar, do të përcaktojë njësitet e auditimit që do t'i nënshtrohen vlerësimit të jashtëm të cilësisë, në periudhën e programuar, por pa u shmangur nga respektimi i afatit të standardit (jo më pak se një herë në 5 vjet).

Respektimi i afatit të standardit në kryerjen e vlerësimeve të jashtme nga SPHAB do të ndikohet nga burimet e vlerësimit, ku përfshihen elementë si:

- Stafit që do të angazhohet për secilin mision, i cili do të vendoset në përputhje me parashikimet për vlerësim të jashtëm të cilësisë.
- Koha në dispozicion të çdo angazhimi e cila llogaritet në vartësi të madhësisë dhe kompleksitetit të njësisë së auditimit që do të jetë subjekt i procesit të vlerësimit.

## KAPITULLI 2 – PROCESI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në programin e hartuar, procesi i vlerësimit të jashtëm të cilësisë do të kryhet sipas hapave të mëposhtëm:




Figura 1. Hapat e procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë

Hapat e procesit të vlerësimit të jashtëm trajtohen më në detaje më poshtë, si dhe në kapitullin 3 “Raportimi” dhe kapitullin 4 “Monitorimi i progresit”:

### 1. Njoftimi i fillimit të misionit të vlerësimit

Drejtuesi i strukturës përgjegjëse të harmonizimit të AB-së, përgatit :

a) Autorizimin në të cilin përcaktohet grupi i vlerësuesve të jashtëm;

b) Shkresën për fillimin e misionit të vlerësimit (sipas formatit në MAB), e cila i dërgohet NJAB-së, **5 ditë kalendarike** përpara takimit fillestar, me qëllim krijimin e kushteve të bashkëpunimit. Në raste të veçanta, drejtuesi i strukturës përgjegjëse të harmonizimit për AB-në, mund të mos e njoftojë paraprakisht NJAB-në që do të vlerësohet (përfshirë rastet e një çështje të publikuar në media, etj.), por ky veprim duhet të argumentohet dhe të dokumentohet në dosjen e punës.

## **2. Përgatitja e programit të vlerësimit dhe listave verifikuese**

Pas përcaktimit të grupit të vlerësuesve të jashtëm të cilësisë dhe nënshkrimit të deklaratës së pavarësisë nga ana e tyre, nisin procedurat për hartimin e programit të vlerësimit dhe listave verifikuese, si një proces i detajuar për çdo angazhim vlerësimi.

Programi do të përfshijë informacionin e nevojshëm për të kryer misionin dhe ky dokument do të nënshkruhet nga grupi i punës i vlerësuesve dhe miratohet nga drejtuesi i strukturës përgjegjëse të harmonizimit të AB-së.

Si një dokument orientues, ai duhet të përmbajë objektin e vlerësimit, subjektin, qëllimin, afatet kohore të realizimit, si dhe listën verifikuese. Afati i përgatitjes së programit dhe listës verifikuese, caktohet në autorizimin për fillimin e misionit të vlerësimit.

## **3. Takimi fillestar me njësinë e auditimit të brendshëm**

Grupi i vlerësimit duhet të takohet me stafin përkatës të njësisë subjekt i vlerësimit përpara se të fillojë misionin. Në takimin fillestar (projekt-axhenda) me njësinë që do të vlerësohet, duhet të diskutohen hapur objektivat dhe afatet për raportim. Minutat e takimit duhet të dokumentohen dhe të dakordësohen, sipas formatit standard të MAB-së.

## **4. Shqyrtimi i plotësisë të kritereve kryesore, dytësore dhe përcaktimi i përputhshmërisë me standardet e veprimtarisë së NJAB-së. Plotësimi i listave verifikuese sipas aneksit nr.1**

Sistemi i vlerësimit të jashtëm ka si objektiv kryesor identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim në veprimtarinë e njësisë të auditimit të brendshëm dhe jo krahasimin ndërmjet tyre.

Vlerësimi i jashtëm, sipas kësaj metodike që do të kryhet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm apo nga vlerësues të kualifikuar të pavarur, mbështetet në analizimin e shkallës së përputhshmërisë së veprimtarisë së njësisë së auditimit të brendshëm me parimet e parashikuara në një grup të caktuar standardesh ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

Nisur nga përmbajtja dhe rëndësia që kanë në funksionimin e NJAB-së, grupi i standardeve të cilat konsiderohen shumë të rëndësishme për opinionin përfundimtar të vlerësimit janë: 1100, 1200, 2000, 2200, 2300, (ISPPIA). Kjo nënkupton se nëse ekziston qoftë dhe një papajtueshmëri e lartë (që pëfaqësohet nga rezultati i kuq) me këto standarde specifike, vlerësimi i përgjithshëm do të rezultojë negativ.

Rezultatet e vlerësimit janë opinione që kanë të bëjnë me:



- zbatueshmërinë e standardeve, ligjit, dhe praktikave më të mira profesionale nga njësitë e auditimit të brendshëm dhe drejtuesit e tyre;
- zbatueshmërinë e përgjegjësive nga ana e titullarit mbi kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm të njësisë publike të tij.

Shkalla e zbatimit të standardeve ndërkombëtare për praktikat më të mira në veprimtarinë e NjAB-së vlerësohet duke u fokusuar në kriteret, që kanë të bëjnë me rolin specifik të auditimit të brendshëm dhe që rezultojnë nga pyetjet prej të cilave adresohen. Përfundimet për shkallën e zbatimit të secilit standard do të bazohen në shqyrtimin e kriterëve kryesore dhe dytësore, hapave të shqyrtimit të përputhshmërisë me kriterin si dhe vlerësimin (konkluzionin) mbi shkallën e përputhshmërisë. Kriteret sipas të cilave kryhet ky vlerësim ndahen në grupe si më poshtë:





#### ***Kritere kryesore të vlerësimit***

Konsiderohen të tilla, sepse mospërputhja me këto kritere sjell menjëherë një rezultat negativ, i cili ndikon shumë në vlerësimin e përgjithshëm përfundimtar.

#### ***Kritere dytësore të vlerësimit***

Konsiderohen të tilla, sepse mospërputhja me një kriter dytësor të vlerësimit nuk ka një ndikim të ndjeshëm në vlerësimin e përgjithshëm përfundimtar. Nëse ka dy ose më shumë raste të mospërputhjes me kriteret dytësore të vlerësimit, atëherë rezultati përfundimtar është automatikisht negativ.

Përputhshmëria me një **kriter kryesor** vlerësimi paraqitet nga katër rezultate të mundshme, të ilustruar me ngjyra:

-  të gjelbër, përputhje e plotë me kriterin
-  të verdhë, përputhje e pjesshme me kriterin, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara
-  portokalli, përputhje në disa fusha që kërkojnë përmirësime kritike (të domosdoshme) apo
-  të kuqe, mospërputhje e plotë me kriterin.

Përputhshmëria me një **kriter dytësor** vlerësimi paraqitet nga dy rezultate: e gjelbër ose e kuqe.

Qëllimi kryesor i kryerjes së vlerësimit të jashtëm të cilësisë është sigurimi i respektimit dhe zbatimit në një nivel të lartë të standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm si dhe identifikimi i fushave që kërkojnë përmirësim në veprimtarinë e NJAB-së, në të cilën kryhet ky vlerësim.

Në nivelin e zbatimit të një standardi ndërkombëtar për praktikat profesionale të auditimit të brendshëm (ISPPA), ngjyrat kanë të njëjtin kuptim (dmth si në vlerësimin e zbatimit të kriterit, ashtu dhe të standardit, secila nga ngjyrat tregon:

- e gjelbër -përputhje të plotë me kriterin/standardin;
- e verdhë - përputhje të pjesshme me kriterin/standardin;
- portokalli -përputhje në disa fusha me kriterin/standardin;

- e kuqe - mospërputhje të plotë me kriterin/standardin.

**Ngjyra e përcaktuar në vlerësimin për secilin standard, ka lidhje me përputhshmërinë midis veprimtarisë së auditimit dhe standardit që shqyrtohet, dhe jo thjesht me kriterin.**

**Në nivelin e përgjithshëm të vlerësimit, ngjyrat përfaqësojnë pajtueshmërinë me gjithë grupin e standardeve.**

**Shembulli** ilustron, vlerësimin mbi përputhshmërinë me kriteret e Standardeve Atributive (ISPPIA-1000), duke pasqyruar hapat përkatës të shqyrtimit, me qëllim dhënien e një vlerësimi përfundimtar për shkallën e zbatueshmërisë së standardit. Ky vlerësim realizohet nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve që adresojnë kriteret e mëposhtme:

## **Standardi 1000 - Qëllimi, Autoriteti dhe përgjegjësia**

*Qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësitë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm duhet të përcaktohen zyrtarisht në Kartën e auditimit të brendshëm, e cila duhet të jetë në përputhje me përkufizimin e auditimit të brendshëm, Kodin e Etikës dhe standardet. Drejtuesi i auditimit duhet të rishikojë Kartën e auditimit të brendshëm në mënyrë periodike dhe t'ia paraqesë atë menaxhimit të lartë dhe bordit për aprovim.*




### **Kriteri 1**


Si të siguroheni se roli i auditimit të brendshëm është i përcaktuar qartësisht në një dokument themelues (p.sh: karta e auditimit ose rregullore të brendshme).

### **Hapat e shqyrtimit**

- Vlerësoni nëse të gjitha dokumentet themeluese që përshkruajnë rolin e auditimit të brendshëm janë të përgatitura si duhet dhe janë të miratuara.
- Vlerësoni nëse ekziston një proces në NJAB për të përditësuar këto dokumente sa herë që ndodhin ndryshime në standarde.
- Vlerësoni nëse menaxhimi e kupton qartë rolin, autoritetin dhe përgjegjësinë e auditimit të brendshëm.
- Vlerësoni nëse drejtuesi aktual i njësisë publike ka nënshkruar kartën e auditimit të brendshëm.

### **Vlerësim**

-  Dokumentet e duhura ekzistojnë dhe janë përditësuar periodikisht. Menaxhimi kupton plotësisht rolin e auditimit të brendshëm.
-  Dokumentet e duhura ekzistojnë, por ato nuk janë përditësuar në mënyrë periodike kur është e nevojshme. Menaxhimi e kupton plotësisht rolin e auditimit të brendshëm.
-  Dokumentet e duhura ekzistojnë, por menaxhimi nuk e kupton mirë rolin e auditimit të brendshëm.

 Dokumentet e duhura nuk ekzistojnë.


## **Kriteri 2**


Si të siguroheni se auditimi i brendshëm nuk është përgjegjës për çdo veprimtari operacionale.

### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni nëse përgjegjësitë e auditimit të brendshëm janë të përcaktuara qartë në dokumentet themelore të njësisë publike.
- b. Vlerësoni nëse në përshkrimet e punës dhe përgjegjësitë e stafit të auditimit të brendshëm përjashtohen aktivitetet operacionale.
- c. Vlerësoni nëse auditimi i brendshëm nuk është përfshirë gjerësisht në aktivitete të caktuara (për shembull, lufta kundër korrupsionit, parandalimin dhe hetimin e mashtrimit etj), të cilat mund të krijojnë perceptimin se auditimi i brendshëm është përgjegjës për këto aktivitete.
- d. Vlerësoni nëse audituesit e brendshëm nuk po marrin pjesë, në fakt ose në dukje, në çdo proces vendimmarrjeje.
- e. Vlerësoni nëse audituesve të brendshëm u kërkohet të nënshkruajnë rregullisht deklaratën e pavarësisë.
- f. Vlerësoni nëse ekzistojnë raste kur audituesit e brendshëm kanë qenë përgjegjës për aktivitete operacionale.

### **Vlerësim**

 Audituesit e brendshëm nuk kanë përgjegjësi operacionale.

 Audituesit e brendshëm kanë përgjegjësi operacionale të përhershme ose të rastit, në fakt ose në dukje.





## **Kriteri 3**

Si të siguroheni se audituesit e brendshëm kanë akses të pakufizuar në informacion, mjete dhe punonjës.

### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni nëse dokumentet themelore u garantojnë audituesve të brendshëm akses të pakufizuar në informacion, mjete dhe punonjës (staf i njësisë që auditohet).
- b. Vlerësoni nëse termi "akses i pakufizuar" është përcaktuar si duhet.
- c. Vlerësoni nëse aksesit në informacion është i lidhur me një klasifikim të informacionit (konfidencial, të klasifikuara, etj).
- d. Vlerësoni nëse audituesit e brendshëm kanë autorizimin e duhur për të shqyrtuar informacion konfidencial.
- e. Vlerësoni nëse ekziston një procedurë konkrete e përshkallëzuar, në rastet kur aksesit në informacion, punonjës apo asete u është mohuar audituesve të brendshëm.
- f. Vlerësoni nëse ka patur raste, në të cilat aksesit është mohuar.

## Vlerësim

-  Nuk ka kufizime për audituesit e brendshëm për të patur akses në informacion, asete dhe punonjës.
-  Aksesit ekziston në parim, por autorizimi specifik kërkohet për çdo angazhim auditimi.
-  Aksesit ekziston, por jo për të gjitha informatat.
-  Aksesit është i kufizuar dhe fushëveprimi i auditimit të brendshëm mund të jetë i kufizuar.



## Kriteri 4

Si të siguroheni se linjat e raportimit të auditimit të brendshëm janë të përcaktuara qartë.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni nëse dokumentet themelore ofrojnë linjë raportimi ndërmjet njësisë së auditimit të brendshëm dhe titullarit të nivelit më të lartë në njësinë publike (për shembull, Ministri)
- b. Vlerësoni nëse është përcaktuar në mënyrë të qartë linja e raportimit së njësisë së auditimit të brendshëm me strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm
- c. Vlerësoni nëse të gjitha linjat e raportimit zbatohen në praktikë.
- d. Vlerësoni nëse dokumentet themelore përshkruajnë komunikimin ndërmjet njësisë së auditimit të brendshëm dhe subjektit të audituar.
- e. Vlerësoni nëse dokumentet themelore përshkruajnë përgjegjësitë e subjektit të audituar për t'iu përgjigjur gjetjeve të auditimit (për të paraqitur observacione / kundërshtime).
- f. Vlerësoni nëse auditimi i brendshëm përgatit raporte periodike të aktivitetit, të cilat theksojnë kufizimet e kapaciteteve njerëzore, buxhetore, dhe çështje të tjera të burimeve.

## Vlerësim

-  Linjat e raportimit të auditimit të brendshëm janë të përcaktuara mirë dhe të respektueshme në praktikë.
-  Linjat e raportimit të auditimit të brendshëm nuk janë të përcaktuara mirë, ose nuk respektohen në praktikë.



## Kriteri 5

Si të siguroheni se të gjithë audituesit e brendshëm janë të vetëdijshëm për rolin dhe përgjegjësitë e auditimit të brendshëm.

## Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni nëse të gjithë punonjësit janë të mirëinformuar rreth dokumenteve themelore, të cilat përshkruajnë rolin dhe përgjegjësitë e auditimit të brendshëm.
- b. Vlerësoni nëse të gjithë punonjësve u janë bërë me dije ndryshimet e dokumenteve themelore.
- c. Vlerësoni nëse roli i auditimit të brendshëm është shpjeguar qartë për punonjësit e rinj.
- d. Vlerësoni nëse auditimi i brendshëm përdor një shumëllojshmëri mekanizmesh për rritjen e vetëdijes mbi rolin dhe përgjegjësitë e tij në njësinë publike. P.sh, njësia e auditimit të brendshëm ka hartuar një dokument, i cili është në dispozicion në faqen zyrtare të internetit, ku përfshihen pyetjet më të shpeshta që shpjegojnë me fjalë të qarta rolin e auditimit të brendshëm, si dhe të drejtat dhe detyrat e subjekteve të audituara.
- e. Vlerësoni nëse auditimi i brendshëm thekson rolin e tij gjatë takimeve fillestare me subjektet që do të auditohen.

## Vlerësim

-  Auditimi i brendshëm përdor shumëllojshmëri të mekanizmave për rritjen e vetëdijes mbi rolin e tij. Të gjithë të punësuarit në njësinë publike janë të vetëdijshëm për këtë rol.
-  Nuk ekzistojnë përpjekje për të shpjeguar rolin e auditimit të brendshëm ose të punësuarit nuk janë të vetëdijshëm për këtë rol.


## Kriteri 6


Si të siguroheni se është i qartë dallimi ndërmjet shërbimit të sigurisë dhe shërbimit të këshillimit të ofruar nga auditimi i brendshëm.

## Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni nëse dokumentet themelore parashikojnë ofrimin e shërbimeve të sigurisë dhe këshillimit nga njësia e auditimit të brendshëm.
- b. Vlerësoni nëse dokumentet themelore tregojnë qartë se menaxhimi është përgjegjës i vetëm për çdo veprim që merr shkas nga këshillat apo zbatimi i rekomandimeve të bëra nga auditimi i brendshëm.
- c. Vlerësoni nëse ekziston një procedurë, sipas të cilës menaxherët kërkojnë shërbime të këshillimit nga auditimi i brendshëm.
- d. Vlerësoni raportin ndërmjet shërbimeve të sigurisë dhe shërbimeve të këshillimit në planet e njësisë së auditimit të brendshëm.
- e. Vlerësoni raportet e hartuara pas ofrimit të shërbimeve të këshillimit.

## Vlerësim

-  Auditimi i brendshëm ofron shërbime të sigurisë dhe shërbime të këshillimit, si dhe nuk mban përgjegjësi, në fakt ose në dukje, për veprimet e ndërmarra nga menaxherët, si rezultat i shërbimit të këshillimit të ofruar.

 Auditimi i brendshëm nuk ofron shërbime këshillimi, ose në rast të kundërt, nuk ekziston një perceptim i qartë i përgjegjësive, për veprimet e ndërmarra nga menaxherët që ndjekin këshillat e auditimit të brendshëm.


## **Kriteri 7**


Si të siguroheni se dokumentet themelore u referohen standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse të gjitha dokumentet themelore që përshkruajnë rolin e auditimit të brendshëm janë të hartuara në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuar.
- b. Vlerësoni, nëse zbatimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm është i detyrueshëm në sektorin publik.

### **Vlerësim**

 Dokumentet themelore u referohen standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të pranuar gjerësisht si dhe këto standarde janë zbatuar.

 Dokumentet themelore nuk u referohen standardeve ndërkombëtare të pranuar të auditimit të brendshëm, ose në qoftë se u janë referuar, ato nuk zbatohen në praktikë.


## **Kriteri 8**


Si të siguroheni se dokumentet themelore i referohen Kodit të Etikës për audituesit e brendshëm.

### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse dokumentet themelore janë referuar në një kod etik për audituesit e brendshëm.
- b. Vlerësoni, nëse ky kod etik është në përputhje me Kodin e Etikës për audituesit e brendshëm të miratuar nga IIA.
- c. Vlerësoni nëse audituesit e brendshëm konfirmojnë në mënyrë periodike respektimin e Kodit të Etikës.

### **Vlerësim**


 Dokumentet themelore i referohen një kodi etike për auditimin e brendshëm. Ky kod është në përputhje me Kodin e Etikës së IIA-së. Audituesit e brendshëm në mënyrë periodike konfirmojnë respektimin e parimeve të Kodit të Etikës.

 Dokumentet themelore nuk i referohen një kodi etike për audituesit e brendshëm dhe audituesit e brendshëm nuk konfirmojnë respektimin e vlerave etike.


Vlerësimi në praktikë i plotësimit të kërkesave të standardeve nga NJAB-të, do të shqyrtohet sipas hapave të mëposhtëm:

**HAPI I PARË** Vlerësimi i plotësimit të kërkesave për secilin kriter (kryesor dhe dytësor) të Standardit (standardi 1000 në këtë rast)

**Kriter 1.** Përcaktimi i rolit të auditimit të brendshëm në Kartën e AB dhe rregullore të brendshme.

Vlerësimi-  - përputhje e plotë me kriterin

**Kriter 2.** Auditimi i brendshëm nuk është përgjegjës për veprimtari operacionale.

Vlerësimi-  - përputhje me kriterin, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në disa fusha (psh ndryshimi në përshkrimin e punës, në rregulloren e brendshme)


**Kriter 3.** Auditimi i brendshëm ka akses të pakufizuar në informacion, mjete dhe punonjës.

Vlerësimi -  - përputhje e plotë me kriterin


**Kriter 4.** Linjat e raportimit të auditimit të brendshëm janë të përcaktuara qartë.

Vlerësimi-  - përputhje e plotë me kriterin

**Kriter 5.** Të gjithë audituesit e brendshëm janë të vetëdijshëm për rolin dhe përgjegjësitë e AB.

Vlerësim-  -përputhje e mirë me kriterin por përmirësimet janë të nevojshme (psh duhet t'ju shpjegohet më qartë audituesve të rinj roli i AB brenda njësisë publike)


**Kriter 6.** Janë kuptuar qartë shërbimet e sigurisë dhe shërbimet e këshillimit që ofron AB.

Vlerësimi-  - mospërputhje e plotë me kriterin (raportet e hartuara për shërbimet e këshillimit nuk japin qartë përgjegjësitë e menaxherëve për veprimet e marra.

**Kriter 7.** Dokumentat themeluese i referohen standardeve ndërkombëtare të AB.

Vlerësimi-  - përputhje e plotë me kriterin




**Kriter 8.** Dokumentet themeluese i referohen një kodi sjellje për audituesit e brendshëm.

Vlerësimi-  - përputhje e plotë me kriterin

Pas vlerësimit të kryer më sipër vërejmë se;

**Kriteret kryesore** që në këtë rast janë Kriter 1 dhe Kriter 3 kanë vlerësimin - 

**Kriteret dytësore** që janë Kriter 2, Kriter 4, Kriter 5, Kriter 6, Kriter 7, Kriter 8 kanë:

- vlerësimin-  -Kriteret 4,7,8;
- vlerësimin-  -Kriter 5;
- vlerësimin-  -Kriteri 2;
- vlerësimin-  - Kriteri 6.

**HAPI I DYTË;** Vlerësimi i përputhjes me standardin ndërkombëtar dhe praktikave më të mira.

Nga vlerësimi i plotësimit të kriterëve të mësipërme dhe duke ju referuar **Formatit 1**, i paraqitur më poshtë,

Vlerësimi i përputhshmërisë së veprimtarisë NJAB-së me standardin që shqyrtohet jepet në kombinimin e paraqitur në rreshtin 8 kur:

**Të gjitha kriteret kryesore (Kriter1,Kriter 3) kanë vlerësim-  dhe një kriter dytësor (Kriter 6) ka vlerësimin-  . Në këto kushte sipas **Formatit 1** rezultati i vlerësimit të përputhjes së veprimtarisë së NJAB-së me standardin është -  që do të thotë **përputhje e mirë me standardin, por janë të nevojshme përmirësimet në fushat e identifikuara gjatë vlerësimit të plotësimit të kriterëve.****



**Format 1. Vlerësimi i përputhshmërisë veprimtarisë NJAB-së me standardin që shqyrtohet.**

Rezultatet e vleresimit		
Kriteret kryesore	Kriteret dytësore	Rezultati i vlerësimit përputhjes me standardin
1.Një kriter vlerësuar i kuq		
2.Dy ose më shumë portokalli		
3.	Dy ose më shumë të kuqe	
4.Një portokalli		
5.Dy ose më shumë të verdha		
6.Një e verdhë	Një e kuqe	
7.Një e verdhë		
8.Të gjitha jeshille	Një e kuqe	
9.Të gjitha jeshile	Të gjitha jeshile	

Pas vlerësimit të përputhshmërisë së veprimtarisë së njësive të auditimit me secilin nga standardet ndërkombëtar sipas mënyrës të shpjeguar për standardin 1000, do të kryhet vlerësimi përfundimtar i cilësisë së veprimtarisë së NJAB-së. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet kombinimit të rezultateve të përputhshmërisë të grupeve të standardeve të parashikuara në këtë metodologji të ndara si në vijim:

Standardet ISPPA 1100, 1200, 2000, 2200, 2300, të cilat konsiderohen **shumë të rëndësishme** për opinionin përfundimtar të vlerësimit nisur nga përmbajtja dhe rëndësia që kanë në funksionimin e NJAB-së, që nënkupton se një papajtueshmëri e lartë (që përfaqësohet nga një rezultat i kuq) me këto standarde specifike menjëherë do të rezultojë në një vlerësim të përgjithshëm negativ.

Standardet ISPPA 1000,1300,2100,2400,2500,2600 të cilat janë **të rëndësishme**, por nuk kanë të njëjtën peshë me standardet e mësipërme në vlerësimin e përgjithshëm (që përfaqësohet nga dy ose më shumë rezultate të kuqe) që vlerësimi i përgjithshëm të jetë negativ. Kombinimet e mundshme për këtë vlerësim kryhen referuar **Formatit 2**, paraqitur më poshtë.

*Vlerësimi i përputhshmërisë së veprimtarisë NJAB me grupin e standardeve të shqyrtuara.*

Konkretisht, për rastin e shembullit të trajtuar më sipër përputhshmëria e veprimtarisë së NJAB-së me standardin 1000 është vlerësuar -

Ky standard është i klasifikuar në grupin e dytë si i tillë është i rëndësishëm, por për vlerësimin e përgjithshëm grupi i standardeve (ISSPA 1100,1200,2000,2200,2300) do të konsiderohet në

fillim, domethënë në qoftë se përputhshmëria e veprimtarisë së NJAB-së me standardin 1100 vlerësohet - [REDACTED] - atëherë vlerësimi përfundimtar do të rezultojë - [REDACTED] - që do të thotë se veprimtaria e NJAB-së nuk kryhet në respektim të standardeve ndërkombëtare të auditimit brendshëm (rreshti i parë i Formatit 2.), po kështu do të konkludohet edhe rastet kur në këtë grup standardesh do të ketë vlerësime të përshkruara në secilin rresht të kolonës së parë, domethënë, kur për shembull për standardin 2000 vlerësimi është - [REDACTED] - për standardin 1200 vlerësimi është - [REDACTED] - jemi në rastin e paraqitur në reshtin e dytë të kolonës 1 të Formatit 2 dhe vlerësimi i përgjithshëm rezulton - [REDACTED]

Me të njejtin arsyetim do të konkludohet edhe në rastet e paraqitura për grupin e standardeve në kolonën e dytë të Formatit 2. (ISSPA- 1000, 1300, 2100, 2400, 2500, 2600). Psh në rastin e shqyrtuar si shembull Standardi 1000 është vlerësuar - [REDACTED] - dhe standardi 2500 është vlerësuar - [REDACTED] - jemi në rastin (një portokalli dhe një e verdhë) rreshti 11, kolona 2 e Formatit 2. Dhe vlerësimi i përgjithshëm në këtë rast rezulton - [REDACTED] - që do të thotë veprimtaria e NJAB-së në përputhje me standardet por kërkohen përmirësime domosdoshmërisht në fushat ku janë identifikuar mangësi të shprehura nëpërmjet rekomandimeve të dhëna nga vlerësuesit e jashtëm të cilësisë qofshin nga struktura e harmonizimit për auditimin e brendshëm apo vlerësues të kualifikuar të pavarur.

**Format 2. Vlerësimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së NJAB-së me grupin e standardeve të shqyrtuara.**

<b>Rezultatet e vlerësimit</b>		
<b>ISSPA 1100,1200,2000,2200,2300</b>	<b>ISSPA 1000,1300,2100,2400,2500,2600</b>	<b>Rezultati përfundimtar i vlerësimit</b>
1.E kuqe		
2.Dy ose më shumë portokalli		
3.	Dy ose më shumë të kuqe	
4.	Një e kuqe dhe një portokalli	
5.	Tre ose më shumë portokalli	
6.Një portokalli		
7.Dy ose më shumë të verdha		
8.	Dy portokalli	
9.	Një e kuqe dhe një e verdhë	
10.	Një e kuqe gjithë te tjerat jeshile	
11.	Një portokalli dhe një e verdhë	
12.	Tre ose më shumë të verdha	
13.Një e verdhë		
14.	Një portokalli gjithë të tjerat jeshile	
15.	Dy të verdha	
16.	Një e verdhë gjithë të tjerat jeshile	
17.Të gjitha jeshile	Të gjitha jeshile	

## KAPITULLI 3: RAPORTIMI

### 1. Projektraporti i vlerësimit të jashtëm të cilësisë

Një pjesë e rëndësishme e këtij procesi është raportimi i gjetjeve të procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë tek menaxhimi i njësisë. Përmes raportimit, menaxhimi dhe drejtuesi i NJAB-së informohen mbi gjetjet e vlerësimit si dhe rekomandimet për përmirësimin e funksionimit të njësisë audituese në të ardhmen.

Kjo metodë pune zbatohet menjëherë pasi ka përfunduar puna në terren, dhe grupi i vlerësimit harton projektraportin e vlerësimit të cilësisë, brenda **10 ditëve kalendarike** nga data e përfundimit të punës në terren.

Të gjitha gjetjet që do të rezultojnë gjatë procesit të vlerësimit të cilësisë, pavarësisht natyrës dhe rëndësisë së tyre, duhet të raportohen. Ky është një parim i rëndësishëm i auditimit të brendshëm.

Pasi ka përfunduar puna në terren, grupi i vlerësimit duhet të dakordësohet me stafin e njësisë së AB-së për saktësinë e gjetjeve faktike.

Projektraporti është raporti i parë përmbledhës i veprimtarisë vlerësuese, që i dërgohet njësisë së audituar me shkresë përcjellëse, sipas formatit të miratuar. Në këtë shkresë i kërkohet menaxhimit të NJAB-së, që brenda **10 ditëve kalendarike** pas përfundimit të misionit të vlerësimit, të reagojë në lidhje me rekomandimet paraprake të paraqitura në projektraport.

### 2. Marrja e komenteve nga drejtuesi i NJAB-së dhe takimi përmblyës

Njësia e AB-së jep komente në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura në fazën e diskutimit të gjetjeve për hartimin e projektraportit.

Drejtuesi i NJAB-së mund të shpjegojë me shkrim komentet në lidhje me përmbajtjen e projektraportit, brenda **5 ditëve kalendarike** nga data e marrjes së tij. Komentet dhe përgjigjet e tij, kur janë të argumentuara nga grupi i vlerësimit, merren parasysh gjatë hartimit të raportit përfundimtar.

Për këtë, nevojitet të organizohet takimi përmblyës, i cili caktohet në marrëveshjen ndërmjet grupit të vlerësuesve të jashtëm dhe NJAB-së, por në çdo rast, ai duhet të mbahet afër datës së përfundimit të raportit, në mënyrë që gjetjet të jenë të vlefshme.

Në takimin përmblyës duhet të jepet një pasqyrë përfundimtare e çështjeve të trajtuara së bashku me rekomandimet përkatëse dhe duhet të marrin pjesë të paktën drejtuesi i grupit të vlerësimit dhe drejtuesi i NJAB-së.

Takimi përmblyës/përmbledhës ka për qëllim arritjen e objektivave të mëposhtme:

- Të sigurojë që të gjitha çështjet e ngritura në projektraport janë të sakta dhe të kuptueshme nga të gjitha palët;

- Të informojë personat përgjegjës dhe menaxhimin në lidhje me gjetjet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë;
- T'i japë një mundësi njësisë së vlerësuar për t'ju përgjigjur komenteve të vlerësuesve të jashtëm.

Grupi i vlerësimit arsyeton dhe shqyrton shpjegimet plotësuese dhe në rast të gjetjes së shpjegimeve të arsyetuara, ndryshon ose plotëson pjesët përkatëse në raportin përfundimtar të vlerësimit.

Në qoftë se subjekti i vlerësuar nuk përgjigjet me shkrim lidhur me pranimin dhe masat për zbatimin e rekomandimeve, si dhe nuk kërkon takim përmbys me grupin e vlerësimit, ky i fundit e konsideron të përmbushur misionin e tij dhe dërgon raportin përfundimtar, duke njoftuar NJAB-në mbi afatin e plotësimit të plan veprimit dhe dërgimin e tij tek vlerësuesit e jashtëm.

### **3. Raporti përfundimtar i vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe plotësimi i planit të veprimit**

Faza finale e kryerjes së procesit të vlerësimit të cilësisë është rënia dakord me njësinë e audituar, lidhur me raportin dhe plotësimin e planit të veprimit, nga kjo e fundit.

Plani i veprimit, do të formojë bazat e punës për ndjekjen e procedurave në të ardhmen dhe duhet t'i dërgohet me shkresë përcjellëse grupit të vlerësimit, jo më vonë se **30 ditë kalendarike** nga data e marrjes të raportit përfundimtar të vlerësimit.

Raporti përmban rekomandime të cilat pasqyrohen në planin e veprimit, i përgatitur sipas formatit standard të MAB-së si më poshtë vijon:

- Numrin e rekomandimeve;
- Rekomandimet;
- Renditja sipas nivelit të riskut;
- Referenca e paragrafit në raport;
- Reagimin e menaxhimit në lidhje me rekomandimet;
- Personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve në NJAB; dhe
- Afatin kohor të zbatimit të rekomandimeve.

Raporti i vlerësimit të jashtëm, duhet t'i përmbahet disa parimeve themelore të komunikimit, që përshkruhen në standardin 2420 ku theksohet se raportet duhet të jenë të sakta, objektive, të qarta, konçize, konstruktive, të plota dhe në kohë.

Një raport i vlerësimit të jashtëm të cilësisë duhet të jenë në përputhje me të gjitha parimet e komunikimit, si në formë ashtu edhe në përmbajtje.

Forma e saktë dhe përmbajtja e raportit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë, duhet të jetë sipas përcaktimeve të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Megjithatë, raporti duhet të përbëhet nga elementët bazë të mëposhtëm:

Tabela 1. Struktura e raportit të vlerësimit

Përmbledhja ekzekutive	Përmbledhja ekzekutive përmban një hyrje të shkurtër për raportin (një ose dy paragrafë) që shpjegon se çfarë është bërë dhe pse është bërë. Kjo pjesë duhet të përfshijë konkluzionet e raportit dhe rekomandimet kryesore.
Hyrja	Hyrja duhet të përcaktojë informacionin mbështetës, arsyen e vlerësimit dhe punën e kryer.
Metoda e vlerësimit	Si e ka kryer punën vlerësuesi? Cila është perioda e mbuluar? A janë kryer intervista ? Cila është metodologjia e përdorur?
Gjetjet dhe konkluzionet	Çfarë gjetën vlerësuesit si rezultat të punës së tyre? Vlerësuesit duhet të përpiqen ta paraqesin këtë në seksione të veçanta, sipas çështjeve që kanë trajtuar, në mënyrë që lexuesi të ndjekë me lehtësi zhvillimin e raportit.
Rekomandimet	Të gjitha rekomandimet duhet të përmbliidhen në një kapitull të posaçëm për NJAB, e cila harton planin e veprimit dhe përgjigjet për të gjitha rekomandimet.

Në rastin kur NJAB vlerësohet nga vlerësues të jashtëm të pavarur, drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm dërgon zyrtarisht në SPHAB një kopje të raportit përfundimtar, së bashku me planin e veprimit të plotësuar, me qëllim:

- Përditësimin e regjistrimit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë;
- Adresimin e problematikave dhe monitorimin e progresit të NJAB-së /dhe
- Shmangien e mbivendosjeve në kryerjen e vlerësimeve.

SPHAB, rezultatet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë (problematikat dhe rekomandimet) i përfshin në raportin për funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik, pjesë e raportit vjetor të konsoliduar për kontrollin e brendshëm në sektorin publik.

## **KAPITULLI 4: MONITORIMI I PROGRESIT**

Drejtuesi i strukturës përgjegjëse të harmonizimit për AB-në monitoron progresin e zbatimit të rekomandimeve të evidentuara në planin e veprimit të plotësuar nga NJAB.

Ky monitorim ofron siguri mbi zbatimin me efektivitet të veprimeve të menaxhimit dhe drejtuesve të NJAB-së si dhe mbi pranimin nga ana e tyre të riskut që vjen nga mosmarrja e veprimeve përkatëse korrigjuese.

Pavarësisht rëndësisë së monitorimit të zbatimit të rekomandimeve, moszbatimi me efektivitet i tyre nga menaxhimi dhe drejtuesi i NJAB-së, do të ndikojë në mungesën e përmirësimit të veprimitarisë së saj. Në rastet e refuzimit të rekomandimeve, arsyet e këtij refuzimi duhet të argumentohen duke:

- vendosur referencat ligjore;
- arsyet objektive dhe subjektive;
- analizën e raportit kosto/përfitim;
- juridiksionin funksional.

Titullari i njësisë publike ka detyrimin që të informojë SPHAB-në mbi zbatimin e të gjitha rekomandimeve për vlerësimet e jashtme të cilësisë së veprimitarisë së NJAB-së. Për këtë, ai duhet të informohet nga drejtuesi i NJAB-së mbi rekomandimet e pazbatuara.

Në qoftë se titullari i njësisë publike, pjesë e vlerësimit, nuk dërgon zyrtarisht të plotësuar planin e veprimit, lidhur me pranimin dhe masat për zbatimin e rekomandimeve, atëherë drejtuesi i SPHAB-së informon Ministrin e Financave, i cili është përgjegjës për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në shkallë vendi, mbi mospërmbushjen e detyrimeve ligjore të menaxhimit të njësisë publike të vlerësuar.

Procedurat e efektshme për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve përmbajnë:

- Vlerësimin dhe verifikimin e përgjigjeve të menaxhimit nëpërmjet raportimeve; dhe
- Sigurinë që autoriteti menaxherial përkatës është vënë në dijeni për përgjigjet e pakënaqshme apo pranimin e risqeve nga NJAB-ja.

## ANEKSI 1: LISTAT VERIFIKUESE

**Kriteret që adresojnë pyetjet për vlerësimin e jashtëm të veprimtarisë së Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik.**

### Standardi 1000 - Qëllimi, Autoriteti dhe Përgjegjësia

*Qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësitë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm duhet të përcaktohen zyrtarisht në Kartën e auditimit të brendshëm, e cila duhet të jetë në përputhje me përkufizimin e auditimit të brendshëm, Kodin e Etikës dhe standardet. Drejtuesi i auditimit duhet të rishikojë Kartën e auditimit të brendshëm në mënyrë periodike dhe t'ia paraqesë atë menaxhimit të lartë dhe bordit për aprovim.*





#### **Kriteri 1**

Si të siguroheni se roli i auditimit të brendshëm është i përcaktuar qartësisht në një dokument themelues (p.sh karta e auditimit ose rregullore të brendshme).

#### **Hapat e shqyrtimit**

- e. Vlerësoni nëse të gjitha dokumentet themeluese që përshkruajnë rolin e auditimit të brendshëm janë të përgatitura si duhet dhe janë të miratuara.
- f. Vlerësoni nëse ekziston një proces në NJAB për të përditësuar këto dokumente sa herë që ndodhin ndryshime në standarde.
- g. Vlerësoni nëse menaxhimi e kupton qartë rolin, autoritetin dhe përgjegjësinë e auditimit të brendshëm.
- h. Vlerësoni nëse drejtuesi aktual i njësisë publike ka nënshkruar kartën e auditimit të brendshëm.

#### **Vlerësim**

-  Dokumentet e duhura ekzistojnë dhe janë përditësuar periodikisht. Menaxhimi kupton plotësisht rolin e auditimit të brendshëm.
-  Dokumentet e duhura ekzistojnë, por ato nuk janë përditësuar në mënyrë periodike kur është e nevojshme. Menaxhimi e kupton plotësisht rolin e auditimit të brendshëm.
-  Dokumentet e duhura ekzistojnë, por menaxhimi nuk e kupton mirë rolin e auditimit të brendshëm.
-  Dokumentet e duhura nuk ekzistojnë.

#### **Kriteri 2**


Si të siguroheni se auditimi i brendshëm nuk është përgjegjës për çdo veprimtari operationale.




## Hapat e shqyrtimit

- g. Vlerësoni nëse përgjegjësitë e auditimit të brendshëm janë të përcaktuara qartë në dokumentet themelore të njësisë publike.
- h. Vlerësoni nëse në përshkrimet e punës dhe përgjegjësitë e stafit të auditimit të brendshëm përjashtohen aktivitetet operacionale.
- i. Vlerësoni nëse auditimi i brendshëm nuk është përfshirë gjerësisht në aktivitete të caktuara (për shembull, lufta kundër korrupsionit, parandalimin dhe hetimin e mashtrimit etj), të cilat mund të krijojnë perceptimin se auditimi i brendshëm është përgjegjës për këto aktivitete.
- j. Vlerësoni nëse audituesit e brendshëm nuk po marrin pjesë, në fakt ose në dukje, në çdo proces vendimmarrjeje.
- k. Vlerësoni nëse audituesve të brendshëm u kërkohet të nënshkruajnë rregullisht deklaratën e pavarësisë.
- l. Vlerësoni nëse ekzistojnë raste kur audituesit e brendshëm kanë qenë përgjegjës për aktivitete operacionale.

## Vlerësim

 Audituesit e brendshëm nuk kanë përgjegjësi operacionale.

 Audituesit e brendshëm kanë përgjegjësi operacionale të përhershme ose të rastit, në fakt ose në dukje.


## Kriteri 3




Si të siguroheni se audituesit e brendshëm kanë akses të pakufizuar në informacion, mjete dhe punonjës.

## Hapat e shqyrtimit

- g. Vlerësoni nëse dokumentet themelore u garantojnë audituesve të brendshëm akses të pakufizuar në informacion, mjete dhe punonjës (staf i njësisë që auditohet).
- h. Vlerësoni nëse termi "akses i pakufizuar" është përcaktuar si duhet.
- i. Vlerësoni nëse aksesit në informacion është i lidhur me një klasifikim të informacionit (konfidencial, të klasifikuara, etj).
- j. Vlerësoni nëse audituesit e brendshëm kanë autorizimin e duhur për të shqyrtuar informacion konfidencial.
- k. Vlerësoni nëse ekziston një procedurë konkrete e përshkallëzuar, në rastet kur aksesit në informacion, punonjës apo asete u është mohuar audituesve të brendshëm.
- l. Vlerësoni nëse ka patur raste, në të cilat aksesit është mohuar.

## Vlerësim

 Nuk ka kufizime për audituesit e brendshëm për të patur akses në informacion, asete dhe punonjës.

-  Aksesit ekziston në parim, por autorizimi specifik kërkohet për çdo angazhim auditimi.
-  Aksesit ekziston, por jo për të gjitha informatat.
-  Aksesit është i kufizuar dhe fushëveprimi i auditimit të brendshëm mund të jetë i kufizuar.



#### **Kriteri 4**

Si të siguroheni se linjat e raportimit të auditimit të brendshëm janë të përcaktuara qartë.

##### **Hapat e shqyrtimit**

- g. Vlerësoni nëse dokumentet themelore ofrojnë linjë raportimi ndërmjet njësisë së auditimit të brendshëm dhe titullarit të nivelit më të lartë në njësinë publike (për shembull, Ministri)
- h. Vlerësoni nëse është përcaktuar në mënyrë të qartë linja e raportimit së njësisë së auditimit të brendshëm me strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm
- i. Vlerësoni nëse të gjitha linjat e raportimit zbatohen në praktikë.
- j. Vlerësoni nëse dokumentet themelore përshkruajnë komunikimin ndërmjet njësisë së auditimit të brendshëm dhe subjektit të audituar.
- k. Vlerësoni nëse dokumentet themelore përshkruajnë përgjegjësitë e subjektit të audituar për t'iu përgjigjur gjetjeve të auditimit (për të paraqitur observacione/kundërshtime).
- l. Vlerësoni nëse auditimi i brendshëm përgatit raporte periodike të aktivitetit, të cilat theksojnë kufizimet e kapaciteteve njerëzore, buxhetore, dhe çështje të tjera të burimeve.

##### **Vlerësim**

-  Linjat e raportimit të auditimit të brendshëm janë të përcaktuara mirë dhe të respektueshme në praktikë.
-  Linjat e raportimit të auditimit të brendshëm nuk janë të përcaktuara mirë, ose nuk respektohen në praktikë.

#### **Kriteri 5**



Si të siguroheni se të gjithë audituesit e brendshëm janë të vetëdijshëm për rolin dhe përgjegjësitë e auditimit të brendshëm.

##### **Hapat e shqyrtimit**

- f. Vlerësoni nëse të gjithë punonjësit janë të mirëinformuar rreth dokumenteve themelore, të cilat përshkruajnë rolin dhe përgjegjësitë e auditimit të brendshëm.
- g. Vlerësoni nëse të gjithë punonjësve u janë bërë me dije ndryshimet e dokumenteve themelore.

- h. Vlerësoni nëse roli i auditimit të brendshëm është shpjeguar qartë për punonjësit e rinj.
- i. Vlerësoni nëse auditimi i brendshëm përdor një shumëllojshmëri mekanizmesh për rritjen e vetëdijes mbi rolin dhe përgjegjësitë e tij në njësinë publike. P.sh, njësia e auditimit të brendshëm ka hartuar një dokument, i cili është në dispozicion në faqen zyrtare të internetit, ku përfshihen pyetjet më të shpeshta që shpjegojnë me fjalë të qarta rolin e auditimit të brendshëm, si dhe të drejtat dhe detyrat e subjekteve të audituara.
- j. Vlerësoni nëse auditimi i brendshëm thekson rolin e tij gjatë takimeve fillestare me subjektet që do të auditohen.

### Vlerësim

-  Auditimi i brendshëm përdor shumëllojshmëri të mekanizmave për rritjen e vetëdijes mbi rolin e tij. Të gjithë të punësuarit në njësinë publike janë të vetëdijshëm për këtë rol.
-  Nuk ekzistojnë përpjekje për të shpjeguar rolin e auditimit të brendshëm ose të punësuarit nuk janë të vetëdijshëm për këtë rol.



### Kriteri 6

Si të siguroheni se është i qartë dallimi ndërmjet shërbimit të sigurisë dhe shërbimit të këshillimit të ofruar nga auditimi i brendshëm.

### Hapat e shqyrtimit

- f. Vlerësoni nëse dokumentet themelore parashikojnë ofrimin e shërbimeve të sigurisë dhe këshillimit nga njësia e auditimit të brendshëm.
- g. Vlerësoni nëse dokumentet themelore tregojnë qartë se menaxhimi është përgjegjës i vetëm për çdo veprim që merr shkas nga këshillat apo zbatimi i rekomandimeve të bëra nga auditimi i brendshëm.
- h. Vlerësoni nëse ekziston një procedurë, sipas të cilës menaxherët kërkojnë shërbime të këshillimit nga auditimi i brendshëm.
- i. Vlerësoni raportin ndërmjet shërbimeve të sigurisë dhe shërbimeve të këshillimit në planet e njësisë së auditimit të brendshëm.
- j. Vlerësoni raportet e hartuara pas ofrimit të shërbimeve të këshillimit.

### Vlerësim

-  Auditimi i brendshëm ofron shërbime të sigurisë dhe shërbime të këshillimit, si dhe nuk mban përgjegjësi, në fakt ose në dukje, për veprimet e ndërmarra nga menaxherët, si rezultat i shërbimit të këshillimit të ofruar.
-  Auditimi i brendshëm nuk ofron shërbime këshillimi, ose në rast të kundërt, nuk ekziston një perceptim i qartë i përgjegjësive, për veprimet e ndërmarra nga menaxherët që ndjekin këshillat e auditimit të brendshëm.



## Kriteri 7

Si të siguroheni se dokumentet themelore u referohen standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

### Hapat e shqyrtimit

- c. Vlerësoni nëse të gjitha dokumentet themelore që përshkruajnë rolin e auditimit të brendshëm janë të hartuara në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuar.
- d. Vlerësoni nëse zbatimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm është i detyrueshëm në sektorin publik.

### Vlerësim

-  Dokumentet themelore u referohen standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të pranuar gjerësisht si dhe këto standarde janë zbatuar.
-  Dokumentet themelore nuk u referohen standardeve ndërkombëtare të pranuar të auditimit të brendshëm, ose në qoftë se u janë referuar, ato nuk zbatohen në praktikë.



## Kriteri 8

Si të siguroheni se dokumentet themelore i referohen Kodit të Etikës për audituesit e brendshëm.

### Hapat e shqyrtimit

- d. Vlerësoni nëse dokumentet themelore kanë referencë në një kod etike për audituesit e brendshëm.
- e. Vlerësoni nëse ky kod etike është në përputhje me Kodin e Etikës për audituesit e brendshëm të miratuara nga IIA.
- f. Vlerësoni nëse audituesit e brendshëm konfirmojnë në mënyrë periodike respektimin e Kodit të Etikës.

### Vlerësim

-  Dokumentet themelore i referohen një kodi etike për auditimin e brendshëm. Ky kod është në përputhje me Kodin e Etikës së IIA-së. Audituesit e brendshëm në mënyrë periodike konfirmojnë respektimin e parimeve të Kodit të Etikës.
-  Dokumentet themelore nuk i referohen një kodi etike për audituesit e brendshëm dhe audituesit e brendshëm nuk konfirmojnë respektimin e vlerave etike.

## Standardi 1100 - Pavarësia dhe objektiviteti

*Veprimtaria e auditimit të brendshëm duhet të jetë e pavarur dhe audituesit e brendshëm duhet të jenë objektiv në përmbushjen e detyrave të tyre.*



### Kriteri 9

Si të siguroheni se është respektuar pavarësia e auditimit të brendshëm.

#### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni dokumentet themeluese në lidhje me pavarësinë e auditimit të brendshëm.
- b. Vlerësoni, nëse drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm ka komunikim të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar me menaxhimin e lartë dhe komitetin e auditimit (aty ku funksionon).

#### Vlerësim

-  Dokumentet themeluese përshkruajnë rëndësinë e pavarësisë së aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm ka komunikim me menaxhimin e lartë.
-  Dokumentet themeluese nuk e përshkruajnë në mënyrë të qartë pavarësinë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Komunikimi me menaxhimin e lartë duket se është i vështirë.



### Kriteri 10

Si të siguroheni se bëhen përpjekje për të garantuar pavarësinë e audituesve të brendshëm.

#### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse rregullat dhe procedurat e vendosura garantojnë pavarësinë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Përshkruani kuadrin ligjor përkatës që garanton pavarësinë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm.
- b. Vlerësoni, nëse rregulloret dhe procedurat e vendosura garantojnë si, pavarësinë organizative dhe atë funksionale të veprimtarisë së auditimit të brendshëm.
- c. Vlerësoni, nëse është i nevojshëm ndonjë përmirësim në kuadrin rregullator të njësisë publike.

#### Vlerësim

-  Dokumentet themeluese, përshkruajnë masat e duhura që do të merren në situata kur pavarësia e auditimit të brendshëm është në rrezik.
-  Dokumentet themeluese, nuk i referohen ndonjë mase ose procesi përshkallëzimi kur pavarësia e auditimit të brendshëm është në rrezik.





## Kriteri 11

Si të siguroheni se aktiviteti i auditimit të brendshëm është i pavarur në fakt dhe në dukje.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse auditimi i brendshëm është i pozicionuar në strukturën organizative në vartësi direkte nga titullari i njësisë publike.
- b. Vlerësoni, nëse titullari i njësisë publike ka deleguar përgjegjësinë për funksionin e auditimit të brendshëm në nivel tjetër, (si; psh. sekretar i përgjithshëm) dhe nëse ky delegim është në përputhje me kuadrin rregullator.
- c. Vlerësoni shpeshhtësinë e takimeve të titullarit të njësisë publike dhe audituesve të brendshëm.
- d. Vlerësoni, nëse auditimi i brendshëm ka marrë ndonjë kërkesë nga titullari i njësisë publike, për t'u përfshirë në veprimtari operacionale të njësisë publike.
- e. Vlerësoni shpeshhtësinë e auditimeve të kryera me kërkesë të titullarit të njësisë publike.
- f. Vlerësoni, nëse shpeshhtësia dhe kohëzgjatja e auditimeve me kërkesë të titullarit të njësisë publike, kanë ndikim në realizimin e planit të auditimit të brendshëm.
- g. Vlerësoni çdo pengesë që kërcënon pavarësinë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, gjatë periudhës në shqyrtim.
- h. Vlerësoni, nëse drejtuesi i NJAB ka ndërmarrë veprimet e duhura, për të minimizuar kërcënimet ndaj pavarësisë së audituesve të brendshëm.

### Vlerësim

-  Veprimtaria e auditimit të brendshëm është e pavarur jo vetëm në fakt, por edhe në dukje.
-  Veprimtaria e auditimit të brendshëm në dukje mund të jetë e pavarur, por drejtuesi dhe stafi i NJAB-së e kanë të vështirë të kundërshtojnë titullarin e njësisë publike.
-  Veprimtaria e auditimit të brendshëm është e pavarur në dukje, por titullari i njësisë publike merr rolin e drejtuesit të NJAB-së dhe dikton veprimtarinë e NJAB-së.
-  Edhe pse pavarësia e veprimtarisë së auditimit të brendshëm përcaktohet në kuadrin rregullator, në realitet nuk është e pavarur. Drejtuesi i NJAB-së mund të zëvendësohet sipas dëshirës /zgjedhjes së titullarit të njësisë publike.

## Kriteri 12



Si të siguroheni se plani strategjik dhe vjetor i auditimit (angazhimet, burimet, buxheti) janë miratuar në kohën e duhur.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse plani strategjik dhe vjetor i auditimit bazohen në një vlerësim të pavarur dhe objektiv të riskut.
- b. Vlerësoni, nëse plani strategjik dhe vjetor i auditimit janë miratuar në kohën e përcaktuar.

- c. Vlerësoni pengesat kryesore për miratimin e planit strategjik dhe vjetor të auditimit.
- d. Vlerësoni, nëse auditimi i brendshëm është i pavarur për të planifikuar angazhime auditimi.
- e. Vlerësoni, nëse NJAB-ja percepton se është nën presion nga menaxhimi ose titullari i njësisë publike për të ndryshuar planin e saj të auditimit.
- f. Vlerësoni, nëse ka raste në të cilat titullari i njësisë publike nuk e miraton planin e auditimit të hartuar, bazuar në vlerësimin e riskut. Konstatoni arsyen (et) që jepen për mos miratimin e tij.

#### **Vlerësim**

-  Planet strategjike dhe vjetore të auditimit, janë miratuar në afat kohor të përcaktuar.
-  Planet strategjike dhe vjetore të auditimit, nuk janë miratuar. Auditimit të brendshëm ndonjëherë i bëhet presion, për të përjashtuar nga plani i auditimit auditime të rëndësishme.



### **Kriteri 13**

Si të siguroheni se, emërimi i drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm bazohet vetëm në meritë.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse procedurat për emërimin e drejtuesit të NJAB-së është specifikuar në kuadrin ligjor.
- b. Verifikoni, nëse ka kërkesa që specifikojnë kompetencat dhe aftësitë që drejtuesi i NJAB duhet të zotërojë.
- c. Verifikoni, nëse drejtuesi i NJAB-së është emëruar sipas kërkesave të përcaktuara.

#### **Vlerësim**

-  Ka aftësi dhe kompetenca të përshtatshme me kërkesat për emërimin, si drejtues i NJAB. Këto kërkesa janë zbatuar.
-  Nuk ka aftësi dhe kompetenca të përshtatshme me kërkesat për emërimin, si drejtues i NJAB-së ose kërkesat nuk janë respektuar.


### **Kriteri 14**


Si të siguroheni se drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm nuk mund të shkarkohet rastësisht.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse procedurat për shkarkimin e drejtuesit të NJAB-së janë të përcaktuara qartë në kuadrin ligjor.
- b. Verifikoni, nëse një drejtues i NJAB-së është shkarkuar gjatë periudhës në shqyrtim.

### **Vlerësim**

 Ekzistojnë përcaktime të qarta, të cilat përshkruajnë kushtet dhe procesin me të cilin D/NJAB mund të shkarkohet. Këto përcaktime janë zbatuar.

 Ka përcaktime të qarta, të cilat përshkruajnë kushtet dhe procesin me të cilin D/NJAB mund të shkarkohet, por ato nuk janë zbatuar.


### **Kriteri 15**


Si të siguroheni se ekziston një proces i përshkallëzuar, për të mbrojtur nga kërcënimi pavarësinë e audituesve të brendshëm.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse është përshkruar qartë në kuadrin rregullator procedura e përshkallëzuar për mbrojtjen e pavarësisë.
- b. Vlerësoni, nëse ka pasur raste të zbatimit të procedurës të përshkallëzuar, në periudhën në shqyrtim. Vlerësoni rezultatet e këtyre rasteve.

### **Vlerësim**

 Një procedurë e përshkallëzuar ekziston për rastet, kur pavarësia e veprimtarisë së auditimit të brendshëm është e kërcënuar. Kjo procedurë është aplikuar në përputhje me dispozitat përkatëse.

 Nuk ka asnjë procedurë të përshkallëzuar për rastet, kur pavarësia e veprimtarisë së auditimit të brendshëm është e kërcënuar. Rregullat ekzistuese nuk zbatohen në mënyrë të vazhdueshme.


### **Kriteri 16**

Si të siguroheni se auditimit të brendshëm i lejohet të raportojë për gjetjet.


#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse percaktohen rregulla specifike në Kartën e AB-së për pavarësinë dhe objektivitetin, si dhe vlerësoni nëse këto rregulla janë të mjaftueshme.
- b. Vlerësoni, nëse titullari i njësisë publike ka miratuar Kartën e AB-së.
- c. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm janë njohur me Kartën e AB-së, ose ajo është publikuar në faqen zyrtare të njësisë publike.
- d. Vlerësoni, nëse ka raste në të cilat audituesit e brendshëm kanë raportuar se, janë bërë përpjekje për t'ju ndërhyrë në punën e tyre.

### **Vlerësim**

 Karta e AB-së përmban, dispozita për të mbrojtur pavarësinë dhe objektivitetin e audituesit të brendshëm. Titullari i njësisë publike, ka miratuar këtë dokument dhe ai nuk ndikon në veprimtarinë e auditimit të brendshëm.



 Në Kartën e AB-së, nuk ka dispozita që i referohen pavarësisë dhe objektivitetit të audituesit të brendshëm. Titullari i njësisë publike, nuk e ka miratuar kartën dhe ka bërë përpjekje për të ndikuar në veprimtarinë e auditimit të brendshëm.


### **Kriteri 17**

Si të siguroheni se SPHAB mund të ndihmojë audituesin e brendshëm në rastet kur vërehet se pavarësia e tij është e kërcënuar nga menaxhimi i lartë.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse SPHAB përshkallëzon veprimet në rastet e kërcënimit të pavarësisë së audituesit të brendshëm.
- b. Vlerësoni, nëse kërcënimet ndaj pavarësisë janë shqyrtuar gjatë vlerësimeve të jashtme të kryera nga SPHAB.
- c. Vlerësoni, nëse SPHAB ka mundësi për të dhënë rekomandime për titullarin e njësisë publike, në lidhje me pavarësinë e audituesit të brendshëm.

#### **Vlerësim**

 Nuk është një proces i përshtatshëm përshkallëzimi në nivelin e SPHAB në rastet kur pavarësia e veprimtarisë së auditimit të brendshëm është e kërcënuar. SPHAB ka mundësi për të adresuar çështjet e pavarësisë së aktivitetit të auditimit të brendshëm tek titullarit të institucionit.

 Nuk ka asnjë proces përshkallëzimi në nivelin e SPHAB.


### **Kriteri 18**


Si të siguroheni se auditimi i brendshëm është i informuar në kohën e duhur, për vendimet e rëndësishme që merren nga menaxhimi i lartë i njësisë publike.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse Drejtuesi i NJAB-së merr pjesë në takimet e menaxhimit të lartë të njësisë publike.
- b. Vlerësoni, nëse përshkruhet në një dokument apo rregullore të brendshme, roli dhe pjesëmarrja e Drejtuesit të NJAB-së në takimet me menaxhimin e lartë.
- c. Vlerësoni, nëse roli i Drejtuesit të NJAB-së, në takimet me menaxhimin e lartë, është i kufizuar vetëm në veprimtarinë e auditimit të brendshëm.

#### **Vlerësim**

 Drejtuesi i NJAB-së është i ftuar në mënyrë sistematike për të marrë pjesë në takimet e menaxhimit të lartë.

 Drejtuesi i NJAB-së nuk është i ftuar vazhdimisht (rrallë ose asnjëherë) të marrë pjesë në takimet e menaxhimit të lartë.


## Kriteri 19


Si të siguroheni se ekziston një proces që merret me shqyrtimin e konflikteve të mundshme të interesit të auditueve të brendshëm.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse ka dokument që përcakton rëndësinë e objektivitetit të auditimit të brendshëm.
- b. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm janë të detyruar të nënshkruajnë një deklaratë në lidhje me ndonjë konflikt interesi, përpara fillimit të çdo angazhimi auditimi.
- c. Vlerësoni, nëse të gjithë audituesit e brendshëm në praktikë nënshkruajnë këtë deklaratë, para fillimit të çdo angazhimi auditimi.
- d. Vlerësoni, nëse ka pasur ndonjë rast të konfliktit të interesit, nëse po si është trajtuar ai.

### Vlerësim

 Parimi i objektivitetit dhe konflikti i interesit janë të dokumentuara në ligj. Audituesit e brendshëm respektojnë përcaktimet ligjore.

 Parimi i objektivitetit dhe konflikti i interesit nuk janë të përcaktuara në ligj, por edhe nëse janë të përcaktuara, audituesit e brendshëm nuk i zbatojnë vazhdimisht këto parime.


## Kriteri 20


Si të siguroheni se auditimi i brendshëm nuk është përgjegjës për çdo veprimtari operacionale.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse ka kufizime në ligj ose në ndonjë rregullore për pjesëmarrjen e AB-së në veprimtari të tjera, të ndryshme nga auditimi i brendshëm.
- b. Vlerësoni, nëse auditimi i brendshëm ka qenë i përfshirë në veprimtari të ndryshme, nga veprimtaria e auditimit të brendshëm.
- c. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm janë caktuar në veprimtari të tjera operacionale, dhe nëse kjo është marrë në konsideratë në planifikimin e angazhimeve të auditimit.
- d. Vlerësoni, nëse janë bërë marrëveshje alternative për raste të tilla, dhe a janë të përshtatshme këto marrëveshje.

### Vlerësim

 Auditimi i brendshëm nuk është përgjegjës për veprimtari të tjera operacionale.

 Auditimi i brendshëm është përgjegjës për veprimtari të tjera operacionale.


## Kriteri 21


Si të siguroheni se auditimi i brendshëm nuk është i përfshirë në hartimin e procedurave për subjektet e audituara.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse ka kufizime në kuadrin ligjor të auditimit të brendshëm, për kryerjen e veprimtarive të tjera operationale të ndryshme nga veprimtaria e auditimit të brendshëm.
- b. Vlerësoni, nëse ka mekanizma që garantojnë autorësinë e vendosjes së kontrolleve të brendshme apo ngritjen e sistemeve nga subjektet e audituara, në rastet kur audituesit e brendshëm marrin pjesë në këto procedura.
- c. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm gjatë planifikimit të angazhimeve të auditimit kanë projektuar procedura për subjektet e audituara. Vlerësoni metodat alternative që janë përdorur, për të trajtuar dëmtimet e mundshme të objektivitetit.

### Vlerësim

 Auditimi i brendshëm nuk harton vazhdimisht procedura për subjektet e audituara. Kur harton, çështjet që kanë të bëjnë me dëmtimin e objektivitetit, adresohen gjatë planifikimit të veprimtarisë të auditimit.

 Auditimi i brendshëm shpesh harton procedura për subjektet e audituara. Kur i harton, dëmtimet e mundshme të objektivitetit nuk janë adresuar, gjatë planifikimit të veprimtarisë të auditimit.


### Kriteri 22


Si të siguroheni se ekziston një proces që identifikon dëmtimet e mundshme të pavarësisë ose objektivitetit.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse kuadri ligjor përcakton qartë procesin e identifikimit të dëmtimit të pavarësisë apo objektivitetit.
- b. Vlerësoni, nëse procedurat identifikuese, përfshijnë kërkesën për të raportuar çështjet e dëmtimit të pavarësisë apo objektivitetit tek SPHAB.
- c. Vlerësoni, nëpërmjet intervistave me audituesit e brendshëm, nëse ata e dinë se çfarë duhet të bëjnë në rastet kur pavarësia apo objektiviteti dëmtohet.

### Vlerësim

 Një proces zyrtar identifikimi që lidhet me dëmtimin e pavarësisë ose objektivitetit, specifikohet dhe përfshin kërkesën për të raportuar të gjitha dëmtimet te SPHAB. Audituesit e brendshëm janë plotësisht në dijeni të procedurave që duhen ndjekur.

 Nuk ka asnjë proces zyrtar identifikimi që raporton dëmtime të pavarësisë ose objektivitetit. Nëse procesi është përcaktuar dhe nuk përfshin kërkesën për të raportuar në SPHAB, ose audituesit e brendshëm nuk janë plotësisht në dijeni të procedurave që duhen ndjekur.



## Kriteri 23

Si të siguroheni se nuk ekziston asnjë kufizim i konsiderueshëm në fushëveprimin e AB-së.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse ka ndodhur ndonjë kufizim i rëndësishëm në fushëveprim për periudhën që shqyrtohet.
- b. Vlerësoni, nëse të audituarit janë informuar siç duhet për të drejtat e AB-së, për të patur akses në informacion.
- c. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm informojnë rregullisht drejtuesin e NJAB-së për kufizimet e fushëveprimit që ndeshen gjatë angazhimeve të auditimit.
- d. Vlerësoni, nëse drejtuesi i NJAB informon titullarin e njësisë publike, kur kufizimet në fushëveprim ndeshen gjatë angazhimit të AB-së.
- e. Vlerësoni, nëse janë zbatuar masat e përshtatshme.

### Vlerësim

-  Nuk kanë ndodhur kufizime të rëndësishme në fushëveprim gjatë periudhës në shqyrtim. Nëse kanë ndodhur kufizime janë adresuar, siç duhet përmes një procesi të përshkallëzuar.
-  Kanë ndodhur kufizime të rëndësishme dhe ato nuk janë adresuar siç duhet.



## Kriteri 24

Si të siguroheni se ka një procedurë që përcakton reagimin ndaj dhuratave të pranuar nga subjektet e audituara ose të tjerë.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse njësia publike ka vendosur rregulla për pranimin e dhuratave nga ana e AB.
- b. Vlerësoni, nëse Kodi i Etikës përcakton procedurat që punonjësit duhet të ndjekin, kur u ofrohen dhurata.
- c. Vlerësoni, nëse ka pasur raste në të cilat audituesve të brendshëm u janë ofruar dhurata gjatë periudhës në shqyrtim.
- d. Vlerësoni përshtatshmërinë e veprimeve që janë ndërmarrë, për rastet kur audituesve të brendshëm u janë ofruar dhurata.

### Vlerësim

-  Ekzistojnë procedura të qarta që përcaktojnë rastet e pranimin të dhuratave nga AB. Këto procedura janë të njohura dhe zbatohen vazhdimisht.
-  Nuk ka procedura të qarta që përcaktojnë rastet e pranimin të dhuratave nga AB. Audituesit nuk janë në dijeni që ekzistojnë këto procedura. Në rastet kur AB kanë pranuar dhurata, ka patur shqetësime për cënimin e objektivitetit.



## Kriteri 25

Si të siguroheni se ka një periudhë mos angazhimi për audituesit e brendshëm, të cilët transferohen nga njësitë operacionale, brenda njësisë publike.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse është caktuar një periudhë mosangazhimi për audituesit e brendshëm, të cilët transferohen nga njësitë operacionale, brenda njësisë publike.
- b. Vlerësoni, nëse kjo periudhë mosangazhimi është në përputhje me kuadrin ligjor.
- c. Vlerësoni, nëse ka raste kur audituesit e brendshëm janë angazhuar në auditime në njësinë që kanë qenë të punësuar, përpara se të punësoheshin në NJAB.

### Vlerësim

-  Ekzistojnë procedura të qarta që përcaktojnë një periudhë të detyrueshme mos angazhimi për audituesit e brendshëm, të transferuar nga njësitë operacionale, brenda njësisë publike. Këto procedura janë të njohura dhe respektohen nga audituesit e brendshëm.
-  Nuk ka procedura të qarta që përcaktojnë një periudhë mosangazhimi për audituesit e brendshëm që transferohen nga njësitë operacionale, brenda njësisë publike. Audituesit e brendshëm, nuk janë plotësisht të vetëdijshëm për procedurat e zbatueshme. Audituesit e brendshëm që transferohen nga njësitë operacionale, brenda njësisë publike nuk kanë respektuar periudhën e kërkuar të mosangazhimit dhe kjo ka ndikuar në objektivitetin e gjykimeve të tyre.


## Kriteri 26


Si të siguroheni se ka një periudhë mosangazhimi për audituesit e brendshëm, të cilët transferohen në njësitë operacionale, brenda njësisë publike.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse është caktuar një periudhë për (ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit) për audituesit e brendshëm, të cilët transferohen në njësi operacionale, brenda njësisë publike.
- b. Vlerësoni, nëse periudha e kërkuar për (ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit), zbatohet në praktikë.

### Vlerësim

-  Ekzistojnë procedura të qarta, që përcaktojnë një periudhë (ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit) për audituesit e brendshëm, që transferohen në njësitë operacionale, brenda njësisë publike. Këto procedura janë të njohura dhe zbatohen nga audituesit e brendshëm.

 Nuk ka procedura të qarta, që përcaktojnë një periudhë për (ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit) për audituesit e brendshëm, që transferohen në njësitë operacionale, brenda njësisë publike. Audituesit e brendshëm, nuk kanë dijeni për procedurat që aplikohen dhe nuk respektojnë periudhën e kërkuar të (ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit), kjo situatë ka ndikuar në objektivitetin e audituesit të brendshëm.



### **Kriteri 27**

Si të siguroheni që një palë e tretë mbikëqyr veprimtarinë, për të cilën funksioni i auditimit të brendshëm ka përgjegjësi.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse ka procedura të përshtatshme për mbikëqyrjen nga një palë e tretë të veprimtarisë së kryer nga NJAB.
- b. Vlerësoni, nëse procedurat e përcaktuara janë zbatuar në praktikë.

#### **Vlerësim**

-  Procedurat për mbikëqyrje të pavarur nga një palë e tretë të veprimtarisë që kryhet nga NJAB, ekzistojnë dhe zbatohen në praktikë.
-  Procedurat për mbikëqyrje të pavarur nga një palë e tretë e veprimtarisë që kryhet nga NJAB, nuk ekzistojnë dhe nëse ekziston ato nuk zbatohen në praktikë.

### **Standardi 1200 - Aftësia dhe Kujdesi i Duhur Profesional**

*Angazhimet e auditimit duhet të kryhen me zotësi dhe me kujdesin e duhur profesional.*

### **Kriteri 28**





Si të siguroheni se të gjithë audituesit e brendshëm, zotërojnë njohuritë dhe aftësitë profesionale, për të përmbushur rolin e tyre.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse janë përcaktuar kompetencat, aftësitë, njohuritë e nevojshme, të cilat duhet të zotërohen nga audituesit e brendshëm dhe që janë të rëndësishme për kryerjen e angazhimeve të auditimit. Verifikoni, nëse ato janë përditësuar.
- b. Vlerësoni, nëse ekzistojnë përshkrimet e duhura të punës për audituesit e brendshëm.
- c. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm kanë njohuri për rolin dhe përgjegjësitë e tyre.
- d. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm kanë përvojën e nevojshme dhe nëse zotërojnë certifikatë profesionale “Auditues i brendshëm në sektorin publik”.

- e. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm kanë njohuritë e nevojshme për të kryer punën e tyre.
- f. Vlerësoni, nëse njohuritë e nevojshme vlerësohen para angazhimit të auditimit të brendshëm.
- g. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm me pak përvojë, ndihmohen dhe trajnohen për zgjidhjen e problematikave që ndeshen gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre.

### **Vlerësim**

-  Audituesit e brendshëm, zotërojnë aftësitë e nevojshme, përvojën dhe kompetencën e duhur për kryerjen e angazhimeve të auditimit të brendshëm. Këto njohuri, përditësohen rregullisht dhe dobësitë e identifikuara korigjohen në kohën e duhur, duke përdorur burimet që kanë në dispozicion NJAB-të.
-  NJAB nuk ka në përbërje auditues të brendshëm me njohuritë, përvojën dhe kompetencat e nevojshme, por gjen zgjidhje të pranueshme për të menaxhuar mangësitë e identifikuara të aftësive të tyre.
-  Të gjithë audituesit e brendshëm, nuk zotërojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme, për të kryer angazhimet e planifikuara të auditimit. Fushëveprimi i angazhimit të auditimit është i përshtatur me aftësitë e audituesve të brendshëm.
-  Të gjithë audituesit e brendshëm, nuk zotërojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme, për të përmbushur rolin e tyre, megjithatë kryejnë angazhime të auditimit.



### **Kriteri 29**

Si të siguroheni që audituesit e brendshëm, janë në gjendje të planifikojnë dhe të zbatojnë manualin e auditimit të brendshëm.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB) është i përshtatshëm për auditimin e fushave dhe sistemeve të veçanta të njësisë publike.
- b. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm kuptojnë plotësisht metodologjinë e përcaktuar, për kryerjen e angazhimeve të auditimit.
- c. Vlerësoni, nëse janë kryer trajnime për metodologjinë e auditimit dhe nëse është ajo në përditësim të vazhdueshëm.
- d. Vlerësoni, nëse ekzistojnë procedurat të përshtatshëm të auditimit të brendshëm.
- e. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm janë njohur me këto procedurat.

### **Vlerësim**

-  MAB ka përcaktuar procedurat e duhura dhe të përshtatshme për auditimin e fushave dhe sistemeve të veçanta, të njësisë publike. Audituesit janë të trajnuar për të aplikuar metodologjinë e përcaktuar.
-  Audituesit, njohin procedurat e përcaktuara në MAB dhe metodologjinë për auditimin e fushave dhe sistemeve të veçanta, të njësisë publike, por nuk e zbatojnë në praktikë.



### **Kriteri 30**

Si të siguroheni se audituesit e brendshëm janë të vëmendshëm ndaj treguesve të mashtrimit (flamujve të kuq).

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm janë të vetëdijshëm se mashtrimi është një risk i rëndësishëm për t'u marrë parasysh, gjatë kryerjes së angazhimeve të auditimit.
- b. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm dinë se si të identifikojnë riskun për mashtrim dhe situatat në të cilat mund të ndodhin.
- c. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm dinë se si të reagojnë ndaj treguesve të mashtrimit.

#### **Vlerësim**

-  Audituesit e brendshëm, janë të vetëdijshëm për mekanizmat dhe treguesit e mashtrimit. Ata e konsiderojnë riskun e mashtrimit në angazhimet e auditimit të brendshëm.
-  Risku i mashtrimit, nuk është konsideruar në mënyrë të vazhdueshme në angazhimet e auditimit të brendshëm.




### **Kriteri 31**

Si të siguroheni se audituesit e brendshëm zotërojnë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për auditimin e mjedisit të teknologjisë së informacionit( IT-së).


#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm zotërojnë njohuri të përshtatshme të mjedisit të IT-së.
- b. Vlerësoni, nëse NJAB-ja ka një specialist të certifikuar për IT-në.
- c. Vlerësoni, nëse është zbatuar një strukturë e tillë si: objektivat e kontrollit për Informacionin e lidhur me Teknologjinë (COB IT) .
- d. Vlerësoni, nëse audituesi i IT-së merret nga jashtë.
- e. Vlerësoni, nëse janë kryer trajnime mbi auditimin e IT-së, për audituesit e brendshëm.

#### **Vlerësim**

-  Audituesit e brendshëm, kanë njohuri të përgjithshme mbi riskun dhe proceset e IT-së. NJAB ka të paktën një auditues të brendshëm të specializuar në IT ose aplikon një zgjidhje alternative.
-  Audituesit e brendshëm, nuk kanë njohuri të përgjithshme mbi risqet dhe proceset e IT-së. NJAB ka të paktën një auditues të specializuar në IT ose aplikon një zgjidhje alternative.
-  Audituesit e brendshëm, nuk kanë njohuri të përgjithshme mbi risqet dhe proceset e IT-së. NJAB nuk ka auditues të specializuar në IT ose aplikon një zgjidhje alternative.



 Audituesit e brendshëm, nuk kanë njohuri të përgjithshme mbi risqet dhe proceset e IT-së. NJAB nuk ka një auditues të specializuar të IT-së dhe nuk aplikon zgjidhje alternative.


### **Kriter 32**


Si të siguroheni se audituesit e brendshëm përdorin mjetet dhe teknikat e duhura, kur kryejnë angazhime të auditimit të teknologjisë dhe informacionit (IT-së).

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse përdorimi i mjeteve dhe teknikave të auditimit të IT-së është përshkruar siç duhet në MAB.
- b. Vlerësoni, nëse mjetet dhe teknikat e auditimit të IT-së përdoren aktualisht nga audituesit e brendshëm për të kryer angazhime auditimi.
- c. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm konsiderojnë përparësitë e përdorimit të mjeteve dhe teknikave të duhura të auditimit të IT-së.
- d. Vlerësoni, nëse trajnimi për mjetet dhe teknikat e auditimit të IT-së është përfshirë në planin e trajnimit për periudhën në shqyrtim.

#### **Vlerësim**

 Mjetet dhe teknikat e auditimit të IT-së janë përdorur nga audituesit e brendshëm në angazhimet e auditimit të kryera.

 Mjetet dhe teknikat e auditimit të IT-së nuk janë përdorur nga audituesit e brendshëm.


### **Kriteri 33**


Si të siguroheni se audituesit e brendshëm bashkëveprojnë në mënyrë të përshtatshme me subjektet e audituara.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse trajnimi mbi menaxhimin e konflikteve (zgjidhjen e problematikave) është përfshirë në planifikimin e nevojave për trajnim.
- b. Vlerësoni si përballen audituesit e brendshëm me sfidat dhe pengesat që hasin.

#### **Vlerësim**

 Audituesit e brendshëm menaxhojnë me sukses problematikat gjatë kryerjes së veprimtarisë.

 Audituesit e brendshëm nuk janë të përgatitur mirë për të zgjidhur problemet ose nuk kryejnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të përshtatshme



### **Kriteri 34**

Si të sigurohemi se audituesit e brendshëm zotërojnë aftësitë e nevojshme të komunikimit.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse aftësitë në komunikim, si tipar i audituesit të brendshëm, janë të përfshirë në planifikimin e nevojave për trajnim.
- b. Vlerësoni, nëse aftësitë e përshtatshme në komunikim janë pjesë e kriterëve të rekrutimit për audituesin e brendshëm.
- c. Vlerësoni, nëse gjetjet e auditimit dëshmojnë profesionalizmin e audituesit të brendshëm.
- d. Vlerësoni, nëse rekomandimet e auditimit janë të dobishme dhe praktike për subjektin e audituar.
- e. Intervistoni punonjësit e subjekteve të audituara (drejtpërdrejtë ose duke përdorur feedback-un e marrë), për të vlerësuar profesionalizmin e audituesve të brendshëm.

#### **Vlerësim**

-  Aftësitë e mira në komunikim janë ndër kriteret më kryesore për rekrutimin e audituesve të brendshëm. Të gjithë audituesit e brendshëm duhet të zotërojnë aftësitë e nevojshme të komunikimit.
-  Jo të gjithë audituesit e brendshëm kanë aftësitë e duhura të komunikimit.



### **Kriteri 35**

Si të siguroheni se ka programe të certifikimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse certifikimi dhe trajnimi i audituesve të brendshëm është i përcaktuar në ligj dhe akte nënligjore.
- b. Vlerësoni, nëse janë planifikuar dhe zbatuar aktualisht programe trajnimi.
- c. Vlerësoni shkallën e përmbushjes së pritshmërive të audituesve të brendshëm nga programi i trajnimit.
- d. Vlerësoni, nëse për audituesit e brendshëm që kryejnë procesin e certifikimit ai pasohet nga trajnimi i vijueshëm profesional çdo vit.
- e. Vlerësoni, nëse trajnimi dhe praktikat aktuale të certifikimit janë në përputhje me kërkesat e parashikuara.

#### **Vlerësim**

-  Certifikimi dhe trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm, janë të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore dhe kërkesat janë përmbushur në mënyrë të vazhdueshme.
-  Certifikimi dhe trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm, nuk janë të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore. Ose në raste ku aktet ligjore dhe nënligjore, kërkesat nuk janë respektuar në praktikë



### **Kriteri 36**

Si të siguroheni se kontraktohen ekspertë të jashtëm, kur audituesit e brendshëm nuk kanë njohuritë dhe aftësitë e duhura.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse kuadri ligjor përcakton procesin e kontraktimit të ekspertëve të jashtëm që ndihmojnë në kryerjen e angazhimit të auditimit të brendshëm.
- b. Vlerësoni në cilat fusha janë të nevojshëm ekspertë të jashtëm. Krahasoni nevojat e identifikuar me efektivitetin e shërbimit të ofruar nga ekspertët e jashtëm.
- c. Vlerësoni, nëse buxheti përfshin pagesën për ekspertë të jashtëm në raste të angazhimeve të pa planifikuara.
- d. Vlerësoni, nëse termat e referencës së ekspertëve të jashtëm janë të përcaktuara qartë në një kontratë ose marrëveshje.
- e. Vlerësoni, nëse ekspertët e jashtëm ofrojnë ekspertizën e duhur për NJAB-në, duke kryer vlerësime në përputhje me specifikat e fushës që auditohet.

#### **Vlerësim**

-  Kuadri ligjor lejon përdorimin e ekspertëve të jashtëm. Ekspertët e jashtëm merren, kur njohuritë, ekspertiza dhe aftësitë e audituesve të brendshëm janë të pamjaftueshme për të kryer një angazhim të auditimit të brendshëm. Buxheti për pagesën e ekspertëve është planifikuar dhe miratuar sipas nevojave.
-  Kuadri ligjor nuk lejon mundësinë e kontraktimit të ekspertëve të jashtëm, ose ka buxhet të limituar që kufizon marrjen e këtij lloji shërbimi. Audituesit e brendshëm kryejnë angazhime auditimi, pa përfshirë ekspertë të jashtëm, në rastet në të cilat ata nuk zotërojnë njohuri, ekspertizë apo aftësitë e duhura.





### **Kriteri 37**

Si të siguroheni se objektivat e auditimit janë të përqëndruar në fushat me risk më të lartë.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm përdorin një metodologji të përshtatshme për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve.
- b. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm gjykojnë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme për vlerësimin e risqeve.
- c. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm kategorizojnë risqet në nivele (I lartë/ I mesëm/ I ulët).
- d. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm marrin në konsideratë opinionin e titullarit të njësisë publike mbi risqet dhe menaxhimin e tyre.

## Vlerësim

-  Audituesit e brendshëm zbatojnë një metodologji të përshtatshme të vlerësimit të riskut. Rezultatet e vlerësimit të riskut, të kryer nga audituesit e brendshëm, janë të konfirmuara nga stafi i menaxhimit të riskut dhe menaxhimi i lartë. Objektivat e angazhimeve të auditimit reflektojnë rezultatet e vlerësimit të riskut.
-  Audituesit e brendshëm zbatojnë një metodologji të përshtatshme të vlerësimit të riskut. Rezultatet e vlerësimit të riskut, të kryer nga audituesit e brendshëm, janë të konfirmuara nga stafi i menaxhimit të riskut dhe nga menaxhimi i lartë. Objektivat e angazhimeve të auditimit nuk pasqyrojnë rezultatet e vlerësimit të riskut.
-  Audituesit e brendshëm zbatojnë një metodologji të përshtatshme të vlerësimit të riskut, por nuk kanë kërkuar opinion nga stafi i menaxhimit të riskut dhe menaxhimi i lartë.
-  Audituesit e brendshëm nuk zbatojnë një metodologji të përshtatshme të vlerësimit të riskut.

## Standardi 1300 - Sigurimi i Cilësisë dhe Programi i Përmirësimit

*Drejtuesi i njësies së auditimit duhet të krijojë dhe të mirëmbajë një program për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë, i cili do të mbulonte të gjitha aspektet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm.*



### Kriteri 38

Si të siguroheni se njësia e auditimit të brendshëm ka një program të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë për veprimtarinë e saj.

#### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse drejtuesi i NJAB ka hartuar një program për vlerësimin e brendshëm të cilësisë.
- b. Vlerësoni, nëse të gjithë audituesit e brendshëm janë njohur me konceptin dhe komponentët e vlerësimit të brendshëm të cilësisë.
- c. Vlerësoni, nëse vlerësimi i brendshëm i cilësisë është kryer rregullisht.

#### Vlerësim

-  Njësia e auditimit të brendshëm kryen vlerësimin e brendshëm të cilësisë. Të gjithë audituesit e brendshëm janë njohur me këtë procedurë.
-  Njësia e auditimit të brendshëm nuk kryen vlerësimin e brendshëm të cilësisë. Në rastet kur kryhet ky vlerësim, audituesit e brendshëm nuk janë njohur me rezultatet e tij.



### **Kriteri 39**

Si të siguroheni se vlerësimi i brendshëm i cilësisë është përcaktuar në kuadrin ligjor të auditimit të brendshëm.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse vlerësimi i brendshëm i cilësisë është përcaktuar në kuadrin ligjor.
- b. Vlerësoni, nëse koncepti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë nuk është përcaktuar në kuadrin ligjor.

#### **Vlerësim**

-  Vlerësimi i brendshëm i cilësisë është përcaktuar në të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore për auditimin e brendshëm.
-  Vlerësimi i brendshëm i cilësisë nuk është i përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore për auditimin e brendshëm

### **Kriteri 40**





Si të siguroheni se vlerësimi i cilësisë përfshin monitorim të vazhdueshëm, vetë-vlerësime të brendshme periodike dhe vlerësime të jashtme të cilësisë të pavarura.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni përmbajtjen dhe metodologjinë e vlerësimit të cilësisë.
- b. Vlerësoni, nëse monitorimi i vazhdueshëm është përcaktuar si një komponent i rëndësishëm në veprimtarinë e auditimit të brendshëm.
- c. Vlerësoni përgjegjësitë për monitorimin e vazhdueshëm.
- d. Vlerësoni mjetet që janë përdorur për monitorimin e vazhdueshëm.
- e. Vlerësoni cilësinë e monitorimit të vazhdueshëm.
- f. Vlerësoni, nëse vetë-vlerësimi periodik është përcaktuar si pjesë e vlerësimit të cilësisë.
- g. Vlerësoni, nëse vetë-vlerësimi periodik është përfshirë në raportimin vjetor (plan, raport) të auditimit.
- h. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm janë të pavarur, objektiv dhe ushtrojnë kujdesin e duhur profesional, gjatë kryerjes së vetë-vlerësimeve periodike.
- i. Vlerësoni mjetet që janë përdorur për vetë- vlerësimet periodike.
- j. Vlerësoni cilësinë e përgjithshme të vetë- vlerësimit periodik.
- k. Vlerësoni, nëse rezultatet e vetë- vlerësimit periodik janë raportuar.
- l. Vlerësoni, nëse i është dhënë rëndësia e duhur rekomandimeve që rezultojnë nga vetë-vlerësimi periodik.
- m. Vlerësoni, nëse vlerësimi i jashtëm i cilësisë kryhet nga rishikues të pavarur në përputhje me metodologjinë e miratuar.
- n. Vlerësoni, nëse në metodologjinë e vlerësimit të cilësisë parashikohet se vlerësimi i jashtëm mund të kryhet nga ekspertë të jashtëm të pavarur ose si vetë-vlerësim me vlefshmërinë e jashtëme të pavarur.

- o. Vlerësoni, nëse ky vlerësim i jashtëm ka qenë i planifikuar në buxhetin e njësisë publike.
- p. Vlerësoni, nëse metodologjia e vlerësimit të cilësisë parashikon pavarësinë dhe kompetencën e ekspertëve që do të kryejnë vlerësimin e jashtëm.
- q. Vlerësoni, nëse rezultatet e vlerësimit të jashtëm janë raportuar.
- r. Vlerësoni, nëse i është dhënë rëndësia e duhur rekomandimeve që rezultojnë nga vlerësimi i jashtëm.

### Vlerësim

-  Metodologjia e vlerësimit të cilësisë përfshin monitorim të vazhdueshëm, vetë-vlerësimet periodike dhe vlerësimet e jashtme të cilësisë të pavarura. Auditimi i brendshëm vazhdimisht kryen të gjitha këto vlerësime.
-  Metodologjia e vlerësimit të cilësisë përfshin, monitorim të vazhdueshëm, vetë-vlerësimet periodike dhe vlerësime të jashtme të pavarura. Auditimi i brendshëm vazhdimisht kryen monitorimin e vazhdueshëm dhe vetë-vlerësimet, por vlerësimet e jashtme nuk janë kryer.
-  Metodologjia e vlerësimit të cilësisë nuk përfshin, të gjitha komponentët (monitorimi i vazhdueshëm, vetë-vlerësime periodike dhe vlerësime të pavarura të jashtme). Auditimi i brendshëm vazhdimisht kryen monitorimin e vazhdueshëm të brendshëm, por vetë-vlerësimet dhe vlerësimet e jashtme nuk janë kryer.
-  Metodologjia e vlerësimit të cilësisë nuk përfshin të gjitha komponentët (monitorimi i vazhdueshëm, vetë-vlerësime periodike dhe vlerësime të pavarura të jashtme). Auditimi i brendshëm nuk kryen monitorime të vazhdueshme, vetë-vlerësimet dhe as vlerësimet e jashtme.



### Kriteri 41

Si të siguroheni se metodologjia e vlerësimit të cilësisë mbulon të gjitha aspektet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm (rolin, vlerësimin e riskut, planifikimin dhe zbatimin e angazhimeve, raportimin dhe trajnimin).

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni përmbajtjen dhe metodologjinë e vlerësimit të cilësisë.
- b. Vlerësoni, nëse performanca aktuale e metodologjisë së vlerësimit të cilësisë është në përputhje me metodologjinë e përcaktuar.
- c. Vlerësoni programin e trajnimit dhe zhvillimit profesional.

### Vlerësim

-  Metodologjia e vlerësimit të cilësisë është e përshkruar dhe e zbatuar në përputhje me përcaktimet.
-  Metodologjia e vlerësimit të cilësisë nuk është e përshkruar. Ose metodologjia është e mjaftueshme, por ajo nuk është aplikuar në përputhje me përcaktimet.


#### **Kriteri 42**


Si të siguroheni se veprimtaria e auditimit të brendshëm ka tregues për të matur performancën e saj.

##### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse treguesit kryesor të performancës janë të përcaktuara në metodologjinë dhe procedurat e auditimit të brendshëm.
- b. Vlerësoni kriteret e treguesve në lidhje me dobinë e tyre.
- c. Vlerësoni, nëse kryhet raportimi i rregullt i treguesve kryesore të performancës.

##### **Vlerësim**

 Treguesit e performancës janë të përcaktuara mirë. Ata janë të matur në mënyrë të vazhdueshme dhe të raportuara.

 Treguesit e performancës nuk ekzistojnë ose janë të përcaktuara dobët.


#### **Kriter 43**


Si të siguroheni se rezultatet e vlerësimit të cilësisë raportohen në mënyrë periodike tek titullari i njësisë publike.

##### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse titullari i njësisë publike është njohur me metodologjisë së vlerësimit të cilësisë.
- b. Vlerësoni, nëse kryhet raportim periodik.
- c. Vlerësoni, nëse Drejtuesi i NJAB-së raporton periodikisht mbi zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë nga vlerësimet të ndryshme (të brendshme dhe të jashtme).

##### **Vlerësim**

 Rezultatet e vlerësimit të cilësisë komunikohen në mënyrë të vazhdueshme tek titullari i njësisë publike. Ai është informuar edhe për zbatimin e rekomandimeve.

 Rezultatet e vlerësimit të cilësisë nuk janë raportuar në mënyrë të vazhdueshme tek titullari i Titullari i njësisë publike.

#### **Kriteri 44**



Si të siguroheni se auditimi i brendshëm në mënyrë periodike kërkon reagime nga subjektet e audituara dhe titullari i njësisë publike.

##### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse pyetësoni i auditimit i dërgohet subjektit të audituar pas përfundimit të çdo angazhimi të auditimit të brendshëm.
- b. Vlerësoni, nëse ky pyetësor i auditimit i është dërguar në mënyrë periodike menaxhimit të lartë.
- c. Vlerësoni, nëse rezultatet e pyetësonit të auditimit janë analizuar si duhet dhe i është dhënë vëmendje e duhur nga Drejtuesi i NJAB-së.

- d. Vlerësoni, nëse rezultatet e pyetësorëve raportohen në mënyrë periodike tek titullari i njësisë publike.

#### **Vlerësim**

-  Njësia e auditimit të brendshëm rregullisht kërkon reagime nga menaxhimi i lartë dhe nga subjektet e audituara. Rezultatet e reagimeve i janë komunikuar titullarit të njësisë publike.
-  Njësia e auditimit të brendshëm nuk kërkon reagime nga menaxhimi i lartë dhe subjektet e audituara në mënyrë të rregullt.



#### **Kriteri 45**

Si të siguroheni se çdo NJAB në mënyrë periodike krahason veten me njësi të tjera (kombëtare dhe ndërkombëtare).

#### **Hapat e shqyrtimit**

- Vlerësoni, nëse NJAB merr pjesë në evente kombëtare dhe ndërkombëtare, ku praktikatat më të mira janë paraqitur dhe diskutuar.
- Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm mbajnë kontakte të rregullta me kolegët.
- Vlerësoni, nëse shërbimi i auditimit të brendshëm vlerëson shkallën e përafritimit me praktikatat më të mira.

#### **Vlerësim**

-  Njësia e auditimit të brendshëm, kryen veprimtarinë e saj paralelisht me trendet aktuale dhe qasjet në auditimin e brendshëm. Njësia e auditimit të brendshëm, vlerëson shkallën e përafritimit me praktikatat më të mira dhe njofton menaxhimin e lartë në lidhje me rezultatet.
-  Njësia e auditimit të brendshëm, nuk kryen veprimtarinë e saj paralelisht me tendencat të fundit në auditimin e brendshëm.


#### **Kriteri 46**

Si të siguroheni se auditimi i brendshëm shton vlerën në njësinë publike.




#### **Hapat e shqyrtimit**

- Vlerësoni, nëse auditimi i brendshëm kujdeset për vlerën që ofron nëpërmjet reagimeve të mbledhura brenda njësisë publike.
- Vlerësoni si audituesi i brendshëm mat vlerën e tij.
- Intervistoni përdoruesit e shërbimeve të auditimit të brendshëm (titullarin e njësisë publike, menaxhimin e lartë, dhe menaxhimin operacional) për vlerën që shtohet nga audituesi i brendshëm nëpërmjet rekomandimeve të tij.

#### **Vlerësim**

-  Auditimi i brendshëm kujdeset për vlerën që ai ofron dhe se si perceptohet kjo vlerë e shtuar nga grupet e interesit. Audituesi i brendshëm mat vlerën e tij me anë të reagimeve të marra nga grupet e ndryshme të interesit.



-  Auditimi i brendshëm kujdeset për vlerën që ai ofron dhe se si e perceptojnë grupet e interesit përfitimin dhe vlerën e shtuar nga auditimi i brendshëm. Grupet e interesit perceptojnë se performanca e auditimit të brendshëm është mesatare dhe ka shumë vend për përmirësim.
-  Auditimi i brendshëm kujdeset për vlerën që ofron por nuk merr në konsideratë perceptimin për vlerat e tij nga grupet e interesit. Grupet e interesuara nuk e shohin si shtues vlerë dhe nuk janë të interesuara për shërbimet e ofruara nga NJAB.
-  Auditimit të brendshëm nuk i intereson nëse shërbimi i ofruar i shton vlerë grupeve të interesit NJAB ka një qasje kontrolluese/ inspektuese dhe vlera e performancës së saj nuk është e ngjashme. Grupet e interesuara e konfirmojnë këtë qëndrim.



#### **Kriteri 47**

Si të siguroheni se deklaratat “në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm”, është mbështetur nga rezultatet e vlerësimeve të cilësisë.

##### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse përdorimi i deklaratës "të kryer në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm" është përcaktuar në metodologji.
- b. Vlerësoni, nëse Drejtuesi i NJAB-së është i familjarizuar me përdorimin e këtij termi. (ISPPA.1321)
- c. Vlerësoni disa nga raportet e auditimit të brendshëm për prezencën e kësaj deklaratë.
- d. Vlerësoni, nëse kjo deklaratë është mbështetur nga rezultatet e vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme të cilësisë.

##### **Vlerësim**

-  Audituesi i brendshëm nuk përdor deklaratën "kryer në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm", Përdorimi i kësaj deklaratë bëhet vetëm nëse është e mbështetur nga rezultatet e dy vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme.
-  Audituesi i brendshëm përdor deklaratën "kryer në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm" në raportet e saj edhe pse përdorimi i deklaratës nuk mbështetet nga rezultatet e vlerësimeve brendshme dhe të jashtme të cilësisë.



#### **Kriteri 48**

Si të siguroheni se çdo mospërputhje me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (ISPPA) është analizuar si duhet në raport.

## Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse zbulimi i mospërputhshmërisë me ISPPA është përcaktuar në metodologji.
- b. Vlerësoni disa nga raportet e auditimit të brendshëm për praninë e zbulimeve të tilla.
- c. Vlerësoni, nëse arsyeja për mospërputhje është shpjeguar qartë.
- d. Vlerësoni, nëse ndikimi i mospërputhjes është përshkruar.

### Vlerësim

-  Audituesi i brendshëm konstaton dhe analizon mospërputhjet me standardet.
-  Audituesi i brendshëm nuk konstaton dhe analizon mospërputhjet me standardet.

## Standardi 2000 - Menaxhimi i Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm

*Drejtuesi i njësisë së auditimit duhet të menaxhojë në mënyrë efektive veprimtarinë e auditimit të brendshëm për të siguruar se auditimi i brendshëm i shton vlerë njësisë.*



### Kriteri 49

Si të siguroheni se ekziston universi i auditimit dhe ai është gjithëpërfshirës, i menaxhueshëm dhe i qëndrueshëm.

#### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse universi i auditimit është i përcaktuar dhe i përditësuar rregullisht.
- b. Vlerësoni, nëse universi i auditimit përbëhet nga të gjitha objektivat, proceset, aktivitetet dhe drejtoritë e njësisë publike.

### Vlerësim

-  Njësia e auditimit të brendshëm, ka njohje të thellë të universit të auditimit i cili përditësohet në kohën e duhur me objektivat e reja, programet, proceset dhe subjektet.
-  Njësia e auditimit të brendshëm, nuk ka përcaktuar një univers të plotë të auditimit.





### Kriteri 50

Si të siguroheni se veprimtaria e auditimit të brendshëm është e mbështetur në një plan të bazuar në risk.

## Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse ekzistojnë procedura të përshtatshme për përgatitjen e një plani auditimi të bazuar në risk.
- b. Vlerësoni, nëse faktorët e riskut, kriteret për vlerësim, niveli i riskut dhe rezultatet kanë qenë të përcaktuara.
- c. Vlerësoni, nëse janë identifikuar dhe vlerësuar risqet që lidhen me objektivat, proceset dhe veprimtaritë e njësisë publike.
- d. Vlerësoni, nëse ndryshimet në objektiva, aktivitete, burime, dhe në mjedisin operacional merren parasysh gjatë kryerjes së vlerësimit të riskut dhe hartimit të planit të auditimit, bazuar në risk.
- e. Vlerësoni, nëse procesi i vlerësimit të riskut është i dokumentuar si duhet.
- f. Vlerësoni, nëse planet strategjike dhe vjetore janë përditësuar periodikisht.
- g. Vlerësoni, nëse planet e auditimit të bazuara në risk, diskutohen me menaxhimin e lartë para miratimit përfundimtar.

## Vlerësim

-  Auditimi i brendshëm harton plane auditimi të bazuara në risk, duke përdorur faktorët e identifikimit të riskut dhe kriteret e vlerësimit të riskut. Menaxhimi i lartë është konsultuar gjatë procesit. Ndryshimet e veprimtarive të njësisë publike rivlerësohen menjëherë. Prosesi i vlerësimit të riskut është i dokumentuar.
-  Auditimi i brendshëm harton plane të auditimit të bazuara në risk, duke përdorur faktorët e identifikimit të riskut dhe kriteret e vlerësimit të riskut. Menaxhimi i lartë është konsultuar gjatë procesit. Ndryshimet në veprimtarinë e njësisë publike nuk rivlerësohen. Prosesi i vlerësimit të riskut nuk është i dokumentuar si duhet.
-  Auditimi i brendshëm harton plane të auditimit të bazuara në risk duke përdorur Faktorët e identifikimit të riskut dhe kriteret e vlerësimit të riskut. Menaxhimi i lartë nuk konsultohet gjatë procesit. Ndryshimet në veprimtarinë e njësisë publike nuk rivlerësohen menjëherë. Prosesi i vlerësimit të riskut nuk është i dokumentuar.
-  Auditimi i brendshëm harton plane të auditimit të bazuara në risk, por nuk i përdorin faktorët e identifikimit të riskut dhe kriteret e përshtatshme të vlerësimit të riskut. Menaxhimi i lartë nuk konsultohet gjatë procesit. Ndryshimet në veprimtarinë e njësisë publike nuk rivlerësohen. Prosesi i vlerësimit të riskut nuk është i dokumentuar.



## Kriteri 51

Si të siguroheni se plani i auditimit të brendshëm merr në konsideratë regjistrin e menaxhimit të riskut që hartohet nga njësi publike.

### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse ekziston regjistri i riskut brenda njësisë publike.
- b. Vlerësoni, nëse regjistri i riskut dhe rezultatet e tij janë vlerësuar nga auditimi i brendshëm.
- c. Vlerësoni, nëse rezultatet e regjistrit të riskut janë konsultuar gjatë hartimit të planit strategjik dhe vjetor të auditimit.

### **Vlerësim**

-  Regjistri i riskut është hartuar dhe është marrë në konsideratë nga auditimi i brendshëm. Regjistri i riskut nuk është hartuar. Ose regjistri i riskut i hartuar nuk është i dobishëm për qëllimin e auditimit të brendshëm.
-  Struktura e administrimit të riskut është e dobishme, por nuk është marrë parasysh nga auditimi i brendshëm.



## **Kriteri 52**

Si të siguroheni se mendimet e menaxhimit të lartë janë kërkuar dhe marrë parasysh për hartimin e planit të auditimit të brendshëm.

### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni mënyrën se si janë kërkuar dhe marrë në konsideratë propozimet e menaxhimit të lartë në hartimin e planit të auditimit të brendshëm.
- b. Vlerësoni arsyetimin e dhënë për përfshirjen në planin e auditimit të fushave të propozuara për auditim nga menaxhimi i lartë.

### **Vlerësim**

-  Propozimet e menaxhimit të lartë janë konsideruar në hartimin e planit të auditimit të brendshëm.
-  Propozimet e menaxhimit të lartë nuk janë konsideruar në hartimin e planit të auditimit të brendshëm.



## **Kriteri 53**

Si të siguroheni se janë analizuar faktorë të përshtatshëm në procesin e vlerësimit të riskut.

### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse faktorët e identifikimit të riskut janë në përputhje me specifikat e proceseve të njësisë publike.
- b. Vlerësoni, nëse janë përcaktuar faktorët kryesorë të identifikimit të riskut.
- c. Vlerësoni, nëse janë identifikuar kriteret e përshtatshme për vlerësimin e riskut.
- d. Vlerësoni, nëse rëndësia dhe pesha e secilit faktor risku është vlerësuar.

### **Vlerësim**

-  Auditimi i brendshëm ka përcaktuar faktorë të përshtatshëm të riskut për procesin e vlerësimit të riskut.
-  Auditimi i brendshëm nuk ka përcaktuar faktorë të përshtatshëm për procesin e vlerësimit të riskut.



### **Kriteri 54**

Si të siguroheni se janë identifikuar si duhet kontrollet kyçe.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse kontrollet që adresojnë një risk kryesor ose një numër risqesh janë identifikuar si duhet.
- b. Vlerësoni, nëse përshtatshmëria e kontrolleve kryesore është analizuar dhe vlerësuar.

### **Vlerësim**

-  Auditimi i brendshëm identifikon kontrollet kyçe, si pjesë e procesit të vlerësimit të riskut.
-  Auditimi i brendshëm nuk identifikon kontrollet kyçe, si pjesë e procesit të vlerësimit të riskut.



### **Kriteri 55**

Si të siguroheni se auditimi i brendshëm mbulon me shërbim të gjitha fushat/sistemet e njësisë publike.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse është përshkruar në planin strategjik mbulimi i të gjithë universit të auditimit.
- b. Vlerësoni, nëse klasifikimi dhe prioritarizimi i proceseve, aktiviteteve, sistemeve dhe fushave për t'u audituar është bërë në përputhje me nivelin e riskut të identifikuar.

### **Vlerësim**

-  Universi i përgjithshëm i auditimit është planifikuar të auditohet për një periudhë të caktuar kohe.
-  Universi i përgjithshëm i auditimit nuk është planifikuar të auditohet për një periudhë të caktuar kohe.



### **Kriteri 56**

Si të siguroheni se plani i auditimit të brendshëm rishikohet periodikisht.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse plani i auditimit rishikohet në rast të ndryshimeve të rëndësishme të universit të auditimit ose kur evidentohen risqe të reja.
- b. Vlerësoni, nëse menaxhimi i lartë është i përfshirë në rishikimin e planit të auditimit.
- c. Vlerësoni, nëse titullari i njësisë publike miraton ndryshimet në planin e auditimit.

### Vlerësim

-  Plani i auditimit shqyrtohet në mënyrë periodike dhe sa herë që ndodhin ndryshime të mëdha në njësinë publike.
-  Plani i auditimit nuk është shqyrtuar në mënyrë periodike dhe kur ndodhin ndryshime të mëdha në njësinë publike.




### Kriteri 57


Si të siguroheni se NJAB ka burime të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të kryer veprimtarinë e saj.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse auditimi i brendshëm analizon periodikisht burimet, që duhen për të kryer angazhimet e auditimit të përshkruara në planin e auditimit.
- b. Vlerësoni, nëse gjatë analizës konsideron aftësitë profesionale dhe numri i nevojshëm i audituesve për kryerjen e angazhimeve të auditimit të brendshëm të planifikuara.
- c. Vlerësoni, nëse njohja e teknologjisë dhe njohuritë për treguesit e mashtrimit janë pjesë e vlerësimit të aftësive të nevojshme.
- d. Vlerësoni, nëse planifikimi i vazhdimësisë është i përfshirë në procesin e vlerësimit.
- e. Vlerësoni, nëse është e nevojshme të punësohen ekspertë të jashtëm.
- f. Vlerësoni, nëse kufizimet e burimeve janë raportuar menjëherë tek menaxhimi.

### Vlerësim

-  NJAB në mënyrë periodike analizon burimet nëse janë të mjaftueshme në sasi dhe cilësi për të kryer angazhimet e auditimit. Analiza, si pjesë e procesit, përmban një vlerësim të aftësive në teknologji, njohuri për identifikimin e riskut për mashtrim. Planifikimi i vazhdimësisë është pjesë e këtij procesi
-  NJAB në mënyrë periodike analizon burimet nëse janë të mjaftueshme në sasi dhe cilësi për të kryer angazhimet e auditimit. Analiza, si pjesë e procesit, nuk përmban një vlerësim të aftësive në teknologji, njohurive për identifikimin e riskut për mashtrim. Planifikimi i vazhdimësisë, nuk është pjesë e këtij procesi.
-  NJAB në mënyrë periodike analizon burimet, nëse janë të mjaftueshme në sasi dhe cilësi për të kryer angazhimet e auditimit. Analiza nuk përmban një vlerësim të aftësive në teknologji (IT) dhe njohurive për identifikimin e riskut për mashtrim. Planifikimi i vazhdimësisë, nuk është pjesë e këtij procesi.

 Auditimi i brendshëm nuk analizon periodikisht burimet, nëse janë të mjaftueshme në sasi dhe cilësi për të kryer angazhimet e auditimit.



## **Kriteri 58**

Si të siguroheni se ndikimi i burimeve të kufizuara i komunikohet menaxhimit të lartë.

### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse është bërë vlerësim i sasisë dhe cilësisë së burimeve të nevojshme për të zbatuar planin e auditimit.
- b. Vlerësoni, nëse është bërë vlerësimi i ndikimit të burimeve të kufizuara.
- c. Vlerësoni, nëse menaxhimi i lartë ka qenë i informuar në kohë rreth burimeve të kufizuara dhe ndikimit të tyre në njësinë publike.

### **Vlerësim**

-  Menaxhimi i lartë është informuar në kohë lidhur me kufizimet e brendshme të burimeve të auditimit.
-  Menaxhimi i lartë nuk është i informuar për ndonjë kufizim të brendshëm të burimeve të auditimit.



## **Kriteri 59**

Si të siguroheni se auditimi i brendshëm përfshin në grupe ekspertë jo-auditues që vijnë nga njësi organizative të tjera brenda njësisë publike.

### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse procedurat lejojnë NJAB për të përfshirë ekspertë (jo-auditues) nga njësi organizative të tjera, brenda njësisë publike për të ndihmuar grupin e auditimit për çështjet teknike specifike.
- b. Vlerësoni, nëse këta ekspertë kanë ndonjë konflikt interesi në lidhje me fushën që do të auditohet.

### **Vlerësim**

-  Auditimi i brendshëm përfshin në grup ekspertë “jo-auditues” të ftuar për të Plotësuar kompetencën e grupit për çështje teknike specifike.
-  Auditimi i brendshëm nuk përfshin ekspertë “jo-auditues” për çështje teknike specifike.


## **Kriteri 60**

Si të siguroheni se auditimi i brendshëm ka procedura të përshtatshme të auditimit dhe këto procedura janë përditësuar.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse procedurat ekzistuese janë të mjaftueshme për të kryer lloje të ndryshme të angazhimeve të auditimit.
- b. Vlerësoni, nëse procedurat aktuale kërkojnë përdorimin e letrave të punës.
- c. Vlerësoni, nëse procedurat përshkruajnë aksesin për arkivimin e dosjeve të auditimit.
- d. Vlerësoni, nëse procedurat janë përditësuar në përputhje me ndryshimet e ndodhura në fushën e auditimit të brendshëm.

### Vlerësim

 Auditimi i brendshëm ka procedura të përshtatshme dhe të përditësuara.

 Auditimi i brendshëm nuk ka procedura të përshtatshme.


### Kriteri 61


Si të siguroheni se veprimtaritë e auditimit të brendshëm janë të koordinuara, si duhet me ofruesit e tjerë të shërbimeve të sigurisë.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse mandatet e ofruesve të tjerë të sigurimit të brendshëm janë të dokumentuara.
- b. Vlerësoni, nëse auditimi i brendshëm ka kryer një vlerësim të punës së këtyre ofruesve të brendshëm të shërbimit të sigurisë.
- c. Vlerësoni, nëse NJAB dhe ofruesit e tjerë të brendshëm të shërbimit të sigurimit shkëmbejnë informacione dhe raporte.
- d. Vlerësoni, nëse aktivitetet e auditimit të brendshëm janë të koordinuara me ofruesit e tjerë të sigurimit të brendshëm për të shmangur dublikimin.
- e. Vlerësoni, nëse auditimi i brendshëm mbështetet në rezultatet e punës nga ofruesit e tjerë të sigurimit të brendshëm.

### Vlerësim

 Auditimi i brendshëm ka vlerësuar punën e ofruesve të tjerë të sigurimit të brendshëm. Auditimi i brendshëm koordinon aktivitetet e tij me këta ofrues.

 Auditimi i brendshëm nuk i koordinon aktivitetet e tij me ofruesit e tjerë të sigurimit të brendshëm.

### Kriteri 62

Si të siguroheni se auditimi i brendshëm koordinon veprimtarinë e tij me Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH).



### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse bashkëpunimi në mes të audituesve të brendshëm dhe të jashtëm është përshkruar në ndonjë dokument zyrtar.
- b. Verifikoni, nëse merret në konsideratë auditimi i jashtëm në procesin e planifikimit të auditimit të brendshëm.
- c. Vlerësoni, nëse audituesit e jashtëm kanë akses në të gjitha dosjet e auditimit të brendshëm.
- d. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm dhe të jashtëm shkëmbejnë informacione dhe raporte.
- e. Vlerësoni, nëse veprimtaritë e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm koordinohen për të shmangur mbivendosjet.

### **Vlerësim**



Audituesi i brendshëm koordinon veprimtaritë e tij me audituesin e jashtëm.



Audituesi i brendshëm nuk koordinon veprimtaritë e tij me audituesin e jashtëm.

### **Kriteri 63**

Si të siguroheni se puna e audituesve të brendshëm respektohet nga audituesit e jashtëm.

### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Intervistoni, nëse është e mundur audituesit e jashtëm që kanë kryer auditimin e njësisë publike.
- b. Intervistoni Drejtuesin e NJAB në lidhje me vlerësimin e KLSH për njësinë e auditimit të brendshëm.

### **Vlerësim**



Auditimi i jashtëm respekton dhe mbështet punën e auditimit të brendshëm.



Auditimi i jashtëm nuk e vlerëson punën e auditimit të brendshëm.



### **Kriteri 64**

Si të siguroheni se auditimi i brendshëm luan rolin e duhur në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të riskut ose hartës së sigurisë.

### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse është hartuar një regjistër risku dhe cili është kontributi i auditimit të brendshëm në këtë proces.
- b. Vlerësoni, nëse është hartuar një hartë e sigurisë dhe cili është kontributi i auditimit të brendshëm.

## Vlerësim

-  Auditimi i brendshëm ka luajtur një rol kyç në hartimin e regjistrit të riskut dhe hartës së sigurisë, kur këto dokumenta ekzistojnë.
-  Auditimi i brendshëm nuk ka patur një rol kyç në hartimin e riskut dhe hartës së sigurisë, kur këto dokumenta ekzistojnë.



## Kriteri 65

Si të siguroheni se linjat e dyta të mbrojtjes brenda njësisë publike janë planifikuar të auditohen.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse universi i auditimit përfshin linjat e dyta të mbrojtjes.
- b. Vlerësoni, nëse janë marrë në konsideratë linjat e dyta të mbrojtjes, gjatë procesit të vlerësimit të riskut.

## Vlerësimi

-  Linjat e dyta të mbrojtjes janë të përfshira në planifikimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm dhe janë shqyrtuar.
-  Auditimi i brendshëm nuk ka planifikuar të auditojë linjat e dyta të mbrojtjes.


## Kriteri 66


Si të siguroheni se veprimtaria e njësisë së auditimit të brendshëm është e koordinuar si duhet me ofruesit e tjerë të jashtëm të shërbimeve të sigurisë.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Verifikoni, nëse mandati i ofruesve të tjerë të jashtëm të shërbimeve të sigurisë është i dokumentuar.
- b. Vlerësoni, nëse njësia e auditimit të brendshëm ka kryer një vlerësim të punës së këtyre ofruesve të jashtëm të shërbimeve të sigurisë.
- c. Vlerësoni, nëse njësia e auditimit të brendshëm dhe ofruesit e tjerë të jashtëm të shërbimeve të sigurisë shkëmbejnë informacione dhe raporte.
- d. Vlerësoni nëse veprimtaritë e njësisë së auditimit të brendshëm dhe ofruesve e tjerë jashtëm të shërbimeve të sigurisë, janë të koordinuara për të shmangur dublikimin.
- e. Vlerësoni nëse njësia e auditimit të brendshëm mbështetet në rezultatet e punës së ofruesve të tjerë të jashtëm të shërbimeve të sigurisë.

## Vlerësim

-  Njësia e auditimit të brendshëm ka vlerësuar punën e ofruesve të tjerë të jashtëm të shërbimeve të sigurisë. Njësia e auditimit të brendshëm koordinon veprimtaritë e saj me këta ofrues.

 Njësia e auditimit të brendshëm nuk e koordinon veprimtarinë e saj me ofruesit e tjerë të jashtëm të shërbimeve të sigurisë.


### **Kriteri 67**


Si të siguroheni si Drejtuesi i NJAB-së i raporton periodikisht titullarit të njësisë publike veprimtarinë e auditimit të brendshëm.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse Karta e Auditimit të Brendshëm dhe procedurat e miratuara përcaktojnë përmbajtjen dhe frekuencën e raportimit të NJAB-së tek titullari i njësisë publike.
- b. Vlerësoni, konsideratën e dobisë së këtyre raporteve nga pikëpamja e titullarit të njësisë publike.

#### **Vlerësim**

 NJAB raporton periodikisht tek titullari i njësisë publike për veprimtarinë e saj. Titullari i vlerëson këto raporte.

 NJAB nuk raporton për veprimtarinë e saj tek titullari i njësisë publike.

### **Standardi 2100-Natyra e punës**

*Vepimtaria e auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë dhe të kontribuojë në përmirësimin e qeverisjes, menaxhimin e riskut dhe proceseve të kontrollit, duke përdorur një qasje sistematike dhe të disiplinuar.*

### **Kriteri 68**


Si të siguroheni se auditimi i brendshëm shqyrton hartimin dhe efektivitetin e programeve etike brenda njësisë publike.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse fokusimi i audituesve të brendshëm mbi çështjet etike në vlerësimin e tyre tek objektivat, programet dhe aktivitetet e njësisë publike.
- b. Vlerësoni, nëse ka theks të mjaftueshme për etikën në angazhimet dhe raportet e auditimit të brendshëm.

#### **Vlerësim**

 Auditimi i brendshëm shqyrton efektivitetin e programeve të ndryshme të etikës.

 Auditimi i brendshëm nuk shqyrton programet e etikës.



## Kriteri 69

Si të siguroheni se rekomandimet e auditimit të brendshëm për menaxhimin e riskut dhe ndarjen e përgjegjësisë janë brenda njësisë publike.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse auditimi i brendshëm jep rekomandim për harmonizimin e programeve, proceseve dhe aktiviteteve të ndryshme lidhur me misionin dhe objektivat e njësisë publike.
- b. Vlerësoni, nëse konceptet e pronësisë dhe përgjegjësisë së riskut janë shqyrtuar në të gjitha angazhimet e auditimit të brendshëm dhe janë pasqyruar në raportet e auditimit.

### Vlerësim

-  Auditimi i brendshëm shqyrton se si janë zbatuar menaxhimi i riskut dhe ndarja e përgjegjësisë brenda njësisë publike.
-  Auditimi i brendshëm nuk e shqyrton menaxhimin e riskut dhe ndarjen përgjegjësisë në angazhimet e auditimit.



## Kriteri 70

Si të siguroheni se auditimi i brendshëm ofron siguri të arsyeshme për procesin e menaxhimit të riskut.


### Hapat e shqyrtimit


- a. Vlerësoni, nëse procesi i menaxhimit të riskut është i përfshirë në universin e auditimit.
- b. Vlerësoni, nëse procesi i menaxhimit të riskut është audituar për shkak se është marrë parasysh situata gjatë ushtrimit të vlerësimit të riskut.
- c. Vlerësoni, nëse auditimi i brendshëm shqyrton efikasitetin e procesit të menaxhimit të riskut.
- d. Vlerësoni, nëse auditimi i brendshëm shqyrton njehsimin e riskut të mbetur me oreksin për risk të njësisë publike.
- e. Vlerësoni, nëse auditimi i brendshëm shqyrton ekzistencën dhe plotësinë e regjistrit të riskut.
- f. Vlerësoni, rolin që luan auditimi i brendshëm në procesin e menaxhimit të riskut.

### Vlerësim

-  Auditimi i brendshëm ofron siguri të arsyeshme për të gjithë komponentët e procesit të menaxhimit të riskut. Auditimi i brendshëm ofron shërbime këshillimi në lidhje me menaxhimin e riskut.
-  Auditimi i brendshëm ofron siguri të arsyeshme për disa komponentë të procesit të

menaxhimit të riskut. Auditimi i brendshëm ofron shërbime këshillimi në lidhje me menaxhimin e riskut.

 Auditimi i brendshëm nuk ofron siguri në procesin e menaxhimit të riskut, por luan një rol këshillues në këtë proces.

 Auditimi i brendshëm nuk ofron siguri të arsyeshme në procesin e menaxhimit të riskut dhe nuk luan ndonjë rol këshillues në këtë proces


## **Kriteri 71**


Si të siguroheni se auditimi i brendshëm i kushton vëmendje të mjaftueshme riskut për mashtrim.

### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse risku për mashtrim është marrë parasysh gjatë procesit të vlerësimit të riskut.
- b. Vlerësoni, nëse risku për mashtrim është marrë parasysh gjatë procesit të planifikimit të angazhimeve individuale të auditimit.

### **Vlerësim**

 Auditimi i brendshëm e konsideron riskun për mashtrim gjatë fazës së vlerësimit të riskut dhe të planifikimit të angazhimeve individuale të auditimit.

 Auditimi i brendshëm nuk i kushton vëmendje të veçantë riskut për mashtrim.


## **Kriteri 72**


Si të siguroheni se auditimi i brendshëm shqyrton efikasitetin dhe përshtatshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.


### **Hapat e shqyrtimit**


- a. Vlerësoni, nëse auditimi i brendshëm në mënyrë sistematike shqyrton efikasitetin (a kontrollohet risku i adresuar?) dhe përshtatshmërinë e kontrolleve (a funksionojnë kontrollet në praktikë?).
- b. Vlerësoni, nëse auditimi i brendshëm në mënyrë sistematike ofron këshilla për efektivitetin dhe përshtatshmërinë e kontrolleve gjatë auditimit të proceseve dhe sistemeve të reja.

### **Vlerësim**

 Auditimi i brendshëm shqyrton efektivitetin dhe përshtatshmërinë e kontrolleve, këshillon njësinë publike për vendosjen e kontrolleve efektive dhe të përshtatshme.

 Auditimi i brendshëm shqyrton efektivitetin dhe përshtatshmërinë e kontrolleve, por nuk ka dhënë këshilla për kontrolle efektive dhe të përshtatshme.

 Auditimi i brendshëm shqyrton kyesisht përshtatshmërinë e kontrolleve të vendosura.

 Auditimi i brendshëm nuk rishikon në mënyrë sistematike efektivitetin dhe përshtatshmërinë e kontrolleve.


### **Kriteri 73**


Si të siguroheni se auditimi i brendshëm ndihmon në dhënien e një opinionit të përgjithshëm mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse titullari i njësisë publike kërkon një opinion mbi efektivitetin dhe përshtatshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- b. Vlerësoni, rolin e auditimit të brendshëm në lidhje me opinionin mbi efektivitetin dhe përshtatshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm
- c. Vlerësoni nëse auditimi i brendshëm mund të shpreh një opinion të bazuar në shqyrtimin e informacioneve dhe dokumentacionit gjatë auditimit të fushave/sistemeve të njësisë publike.

#### **Vlerësim**

 Auditimi i brendshëm shpreh vlerësimin e përgjithshëm mbi përshtatshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, kur i kërkohet për ta bërë këtë. Ky vlerësim mbështetet nga evidenca përkatëse e auditimit.

 Auditimi i brendshëm jep vlerësimin e përgjithshëm për sistemin e kontrollit të brendshëm, pa u mbështetur në evidencën e auditimit.


### **Kriteri 74**


Si të siguroheni se auditimi i brendshëm ofron siguri të arsyeshme për besueshmërinë dhe integritetin e informacionit.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse janë të përfshira në universin e uditimit integriteti dhe besueshmëria e informacionit.
- b. Vlerësoni, nëse gjatë procesit të vlerësimit të riskut i është dhënë vëmendja e duhur integritetit dhe besueshmërisë së informacionit.
- c. Vlerësoni, nëse auditimi i brendshëm shqyrton efikasitetin, integritetin dhe besueshmërinë e informacionit.
- d. Vlerësoni, rolin që luan auditimi i brendshëm në lidhje me integritetin dhe besueshmërinë e informacionit.

#### **Vlerësim**

 Auditimi i brendshëm ofron siguri të arsyeshme mbi integritetin dhe besueshmërinë e informacionit.

 Auditimi i brendshëm nuk ofron siguri të arsyeshme për integritetin dhe besueshmërinë e informacionit

### **Kriteri 75**


Si të siguroheni se auditimi i brendshëm ofron siguri të arsyeshme lidhur me konfidencialitetin e informacionit.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse verifikimi i konfidencialitetit të informacionit është i përfshirë në universin e auditimit.
- b. Vlerësoni, nëse gjatë procesit të vlerësimit të riskut i është dhënë vëmendja e duhur verifikimit të konfidencialitetit të informacionit.
- c. Vlerësoni, nëse auditimi i brendshëm shqyrton efikasitetin e ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit.
- d. Vlerësoni, rolin që auditimi i brendshëm luan në lidhje me konfidencialitetin e informacionit.

#### **Vlerësim**

 Auditimi i brendshëm ofron siguri të arsyeshme mbi konfidencialitetin e informacionit.

 Auditimi i brendshëm nuk ofron siguri të arsyeshme mbi konfidencialitetin e informacionit.

### **Standardi 2200 Planifikimi i angazhimit**

*Audituesit e brendshëm duhet të hartojnë dhe dokumentojnë një plan për çdo angazhim ,duke përfshirë edhe objektivat, objektin, qëllimin, afatet kohore dhe shpërndarjen e burimeve të angazhimit.*



### **Kriter 76.**

Si të siguroheni se auditimi i brendshëm harton dhe zbaton një program të detajuar për çdo angazhim auditimi.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse hartohet plani i detajuar për çdo angazhim auditimi të brendshëm.
- b. Vlerësoni, nëse përgjegjësi i grupit ka ndarë detyrat për çdo program angazhimi.
- c. Vlerësoni, nëse D/NJAB ka nënshkruar çdo program angazhim auditimi.
- d. Vlerësoni nëse programet e angazhim auditimit përfshijnë informacionin e nevojshëm për të kryer auditimet.

### **Vlerësim**

-  Audituesit e brendshëm hartojnë programe të detajuara për të gjitha angazhimet e auditimit të cilat janë të nënshkruara nga personat përgjegjës.
-  Audituesit e brendshëm nuk hartojnë programe të detajuara për të gjitha angazhimet ose programet nuk janë të nënshkruara nga personat përgjegjës.



### **Kriteri 77**

Si të siguroheni se përpara përcaktimit të objektivave të auditimit kryhet një përgatitje paraprake.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse kryerja e fazës përgatitore paraprake është e standardizuar sipas parashikimeve në Manualin e auditimit të brendshëm.
- b. Vlerësoni, nëse ekzistojnë pyetësorë të përshtatshëm për kryerjen e përgatitjeve paraprake.
- c. Vlerësoni, një ose disa dosje për të përcaktuar nëse është dokumentuar kjo fazë përgatitore paraprake.

### **Vlerësim**

-  Audituesit e brendshëm përpara përcaktimit të objektivave të auditimit kryejnë përgatitjen paraprake.
-  Audituesit e brendshëm nuk kryejnë përgatitje paraprake përpara përcaktimit të objektivave të auditimit.



### **Kriteri 78**

Si të siguroheni se auditimi i brendshëm e konsideron mundësinë e gabimeve dhe mashtrimeve.

#### **Hapat e shqyrtimit**

Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm e vlerësojnë mundësinë e gabimeve dhe mashtrimeve, kur kryejnë përcaktimin e nivelit të riskut, përpara hartimit të programit të angazhimit të auditimit.

### **Vlerësim**

-  Audituesit e brendshëm vlerësojnë mundësinë e ndodhjes së gabimeve dhe mashtrimeve përpara përcaktimit të objektivave të auditimit.
-  Audituesit e brendshëm nuk vlerësojnë mundësinë e ndodhjes së gabimeve të rëndësishme dhe mashtrimeve përpara përcaktimit të objektivave të auditimit.







## Kriteri 79

Si të siguroheni se programi i angazhim auditimit të brendshëm përfshin objektiva të qarta dhe përcaktim të saktë të sistemit/fushës që do të auditohet.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse objektivat e auditimit janë të lidhura me risqet e identifikuara gjatë procesit të vlerësimit të riskut.
- b. Vlerësoni, nëse është zhvilluar ndonjë sondazh paraprak i përshtatshëm.
- c. Vlerësoni, nëse risqet e identifikuara janë përditësuar me informacionin e përfituar gjatë fazes përgatitore.
- d. Vlerësoni, nëse janë përcaktuar të gjitha njësitet strukturore, dokumentet dhe asetet që do të jenë objekt i auditimit duke përfshirë edhe punonjësit të cilët do të intervistohen.
- e. Vlerësoni, nëse kohëzgjatja dhe fushëveprimi i auditimit kanë qenë të përcaktuara.
- f. Vlerësoni, nëse është konsideruar ndikimi i kufizimeve të mundshme të fushëveprimit.

### Vlerësim

-  Audituesit e brendshëm përcaktojnë objektiva të qarta auditimi, në përputhje me rezultatet e procesit vjetor të vlerësimit të riskut dhe konkluzionet e përgatitjes paraprake për auditim. Qëllimi është i mjaftueshëm për përmbushjen e objektivave të auditimit.
-  Audituesit e brendshëm përcaktojnë objektiva të qarta auditimi, në përputhje me rezultatet e procesit vjetor të vlerësimit të riskut po jo me konkluzionet e përgatitjes paraprake për auditim. Qëllimi është i mjaftueshëm për përmbushjen e objektivave të auditimit.
-  Audituesit e brendshëm përcaktojnë objektivat e auditimit, të cilat nuk janë në përputhje me rezultatet e procesit vjetor të vlerësimit të riskut dhe konkluzionet e përgatitjes paraprake për auditim. Qëllimi është i mjaftueshëm për përmbushjen e objektivave të auditimit.
-  Audituesit e brendshëm nuk përcaktojnë objektivat e auditimit, në përputhje me rezultatet e procesit vjetor të vlerësimit të riskut dhe konkluzionet e përgatitjes paraprake për auditim. Qëllimi është i pamjaftueshëm për të përmbushur objektivat auditimit.

## Kriteri 80



Si të siguroheni se menaxhimi i njësisë që auditohet është informuar në mënyrën e përcaktuar në aktet ligjore për angazhimin e ardhshëm të auditimit.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse ka një procedurë për të informuar menaxherin në lidhje me angazhimin e ardhshëm të auditimit të brendshëm.
- b. Vlerësoni, nëse kjo procedurë është e plotë dhe aplikohet vazhdimisht.

- c. Vlerësoni, nëse objektivat dhe fushëveprimi i angazhimit të auditimit të brendshëm janë paraqitur në kohën më të shpejtë të mundshme në subjektin që do të auditohet.
- d. Vlerësoni, nëse grupi i auditimit dhe kohëzgjatja e auditimit janë specifikuar.
- e. Vlerësoni, nëse është zhvilluar takim përmbyllës për të diskutuar çështje që lidhen me angazhimin e auditimit të brendshëm.

### **Vlerësim**

-  Auditimi i brendshëm duhet informojë menaxhimin në lidhje me objektivat, qëllimin dhe kohën e angazhimit të ardhshëm të auditimit.
-  Auditimi i brendshëm nuk informon vazhdimisht menaxhimin në lidhje me objektivat, qëllimin dhe kohën e angazhimit të ardhshëm të auditimit.



### **Kriteri 81**

Si të siguroheni se qëllimi i misionit të auditimit të brendshëm është i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm për të arritur objektivat e auditimit duke përfshirë sistemet e rëndësishme, të dhënat, asetet dhe punonjësit e duhur si objekt auditimi.

#### **Hapat e shqyrtimit**

Rishikoni disa dosje të auditimit të brendshëm dhe vlerësoni nëse informacioni/dokumentacioni për sistemet e rëndësishme, të dhënat, asetet dhe punonjësit janë të përfshira.

### **Vlerësim**

-  Fushëveprimi i auditimit të brendshëm është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për të arritur objektivat e auditimit dhe përfshin një rishikim të sistemeve të rëndësishme të të dhënave, për mjetet dhe punonjësit.
-  Fushëveprimi i auditimit të brendshëm nuk është gjithmonë i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për të arritur objektivat e auditimit ose nuk ka gjithmonë të përfshirë një rishikim të sistemeve të rëndësishme të të dhënave për mjetet dhe punonjësit



### **Kriteri 82**

Si të siguroheni se janë planifikuar burime njerëzore të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të kryer angazhime auditimi.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse janë zgjedhur audituesit me aftësitë e duhura profesionale për kryerjen e angazhimeve të auditimit të brendshëm.
- b. Vlerësoni, nëse kur ka qenë domosdoshmëri janë punësuar ekspertë të jashtëm me njohuri në fusha të veçanta.
- c. Vlerësoni, nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme për të përballuar natyrën dhe kompleksitetin e angazhimeve të auditimit të brendshëm.

### **Vlerësim**

-  Burimet e auditimit të brendshëm janë të mjaftueshme dhe janë ndarë në mënyrën e duhur për të kryer angazhimet e auditimit të brendshëm.
-  Burimet e auditimit të brendshëm të caktuara për kryerjen e angazhimeve të auditimit të brendshëm nuk janë vazhdimisht të përshtatshme ose të mjaftueshme.



### **Kriteri 83**

Si të siguroheni se është hartuar një program i hollësishëm i auditimit i cili identifikon të gjitha hapat e nevojshme për të arritur objektivat e auditimit.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse programi i auditimit përfshin metodat dhe teknikat të cilat do të përdoren gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit.
- b. Vlerësoni, nëse hapat e auditimit janë të plota dhe të detajuara për të mundësuar arritjen e objektivave të auditimit.
- c. Vlerësoni, nëse janë ndarë për secilin auditues pjesë e grupit të auditimit drejtimet e programit të auditimit

### **Vlerësim**

-  Për çdo angazhim auditimi janë hartuar programe të hollësishme auditimi.
-  Programet e auditimit nuk janë hartuar ose nuk janë detajuar për të mundësuar arritjen e objektivave të auditimit.



### **Kriteri 84**

Si të siguroheni se programet e auditimit janë miratuar sipas përcaktimeve ligjore.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse drejtuesi i NjAB-së nënshkruan programin për secilin angazhim auditimi i cili përgatitet nga grupi i auditimit.
- b. Vlerësoni, nëse ndryshimet në programin e angazhim auditimit konfirmohen nga drejtuesi i njësisë së auditimit.

### **Vlerësim**

-  Drejtuesi i njësisë së auditimit konfirmon të gjitha programet e angazhim auditimeve dhe ndryshimet në programet e hartuara.
-  Programet e çdo angazhim auditimi apo ndryshimet në programet e hartuara nuk janë të miratuara në mënyrë të vazhdueshme nga drejtuesi i njësisë së auditimit.

## Standardi -2300 Kryerja e angazhimit

*Audituesit e brendshëm duhet të identifikojnë, analizojnë, vlerësojnë dhe dokumentojnë informacione të mjaftueshme për të arritur objektivat e angazhimit.*



### Kriteri 85.

Si të siguroheni se njësi e auditimit të brendshëm zbaton procedurat e përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm për të identifikuar informacionin e mjaftueshëm, të besueshëm dhe të dobishëm gjatë çdo angazhimi auditimi.

#### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm marrin informacionin e nevojshëm, duke kryer intervista, duke bërë pyetje të përshtatshme për punonjësit përkatës, duke respektuar proceset aktuale dhe duke shqyrtuar dokumentet përkatëse (procedurat e brendshme dhe raportet).

#### Vlerësim

-  Audituesit e brendshëm identifikojnë dhe analizojnë të gjithë informacionin e marrë gjatë angazhimit auditimeve të kryera.
-  Audituesit e brendshëm analizojnë informacionin, ose shpenzojnë shumë kohë duke analizuar informacione të pa rendësishme.



### Kriteri 86

Si të siguroheni se audituesit e brendshëm përdorin procedura analitike kur kryejnë angazhime auditimi

#### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse Manuali i auditimit të brendshëm përshkruan se cilat nga metodat dhe teknikat mund të përdoren në rrethana të caktuara.
- b. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm kuptojnë përdorimin dhe vlerat e metodave dhe teknikave të auditimit.

#### Vlerësim

-  Audituesit e brendshëm përdorin metodat dhe teknikat e përshtatshme.
-  Audituesit e brendshëm nuk e kuptojnë se si dhe kur mund të përdorin metodat dhe teknikat e përshtatshme.





## Kriteri 87

Si të siguroheni se audituesit e brendshëm përgatisin dhe përdorin evidenca të përshtatshme për të dokumentuar punën e tyre gjatë kryerjes së angazhim auditimit.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse Manuali i Auditimit të Brendshëm përcakton qartë formën dhe përmbajtjen e dokumenteve të punës.
- b. Vlerësoni, disa dosje auditimi për plotësimin dhe mjaftueshmërinë e dokumenteve të punës.
- c. Vlerësoni, disa dosje auditimi nëse përmbajnë të gjitha evidencat/dokumentat që mbështesin gjetjet.

### Vlerësim

-  Dosja koherente tregon se audituesit e brendshëm mbajnë letrat e punës të cilat dëshmojnë zbatimin e programit të angazhim auditimit të miratuar. Përgatitja e letrave të punës monitorohet vazhdimisht.
-  Audituesit e brendshëm në dosje mbajnë letra pune që devijojnë nga programi i auditimit të miratuar. Letrat e punës janë monitoruar vazhdimisht.
-  Audituesit e brendshëm në dosje mbajnë letra pune që devijojnë nga programi i auditimit të miratuar. Përgatitja e letrave të punës monitorohet por ato nuk janë të kryqëzuara.
-  Audituesit e brendshëm nuk përgatisin letra pune.



## Kriteri 88

Si të siguroheni se përgatitja e letrave të punës është e monitoruar siç duhet.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni, nëse letrat e punës së audituesve të brendshëm janë hartuar në përshtatje me përcaktimet ligjore.
- b. Vlerësoni, nëse letrat e punës dhe dokumentacioni justifikues janë siguruar sipas përcaktimeve ligjore.
- c. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm kanë aksesin e duhur për të kontrolluar dokumentat elektronike.
- d. Vlerësoni nëse audituesit e brendshëm janë të vetëdijshëm për kërkesat për ruajtjen e konfidencialitetit për letrat e punës.

### Vlerësim

-  Aksesi në letrat e punës së audituesve të brendshëm është i organizuar mire dhe respektohen procedurat e përcaktuara në aktet ligjore.
-  Aksesi në letrat e punës së audituesve të brendshëm nuk është i organizuar dhe nuk respektohen procedurat e përcaktuara në aktet ligjore

## **Kriteri 89**


Si të siguroheni se audituesit e brendshëm respektojnë përcaktimet ligjore për përgatitjen e letrave të punës së auditimit.

### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse ekzistojnë përcaktime ligjore për përgatitjen e letrave të punës së auditimit.
- b. Vlerësoni, nëse drejtuesi i NJAB kërkon këshilla ligjore lidhur me afatin e mbajtjes së dosjeve të auditimit në rastet e pasigurisë.
- c. Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm veprojnë në përputhje me kërkesat për procedurën e mbajtjes së dosjeve.

### **Vlerësim**

 Ruajtja e dokumenteve të punës së auditimit është e organizuar mirë.

 Ruajtja e dokumenteve të punës të auditimit nuk është e organizuar mirë.


## **Kriteri 90**


Si të siguroheni se për të gjitha angazhimet e auditimit janë kryer vlerësime të brendshme të cilësisë të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse Manuali përshkruan që të gjitha angazhimet e auditimit duhet t'i nënshtrohen vlerësimit të brendshëm të cilësisë sistematikisht.
- b. Intervistoni stafin për të kuptuar dhe vlerësuar si kryhet vlerësimi i brendshëm i cilësisë.

### **Vlerësim**

 Angazhimet e auditimit i nënshtrohen vlerësimit të brendshëm të cilësisë sipas përcaktimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

 Angazhimet e auditimit nuk i nënshtrohen vlerësimit të brendshëm të cilësisë.

## **Kriteri 91**

Si të siguroheni se vlerësimi i brendshëm i cilësisë është i dokumentuar.

### **Hapat e shqyrtimit**

Rishikoni një shembull në dosjet e auditimit dhe verifikoni se si është kryer vlerësimi i brendshëm i cilësisë.

### Vlerësim



Vlerësimi i brendshëm i cilësisë është dokumentuar si duhet.



Vlerësimi i brendshëm i cilësisë nuk është i dokumentuar.

## Standardi - 2400 Komunikimi i Rezultateve

*Audituesit e brendshëm duhet të komunikojnë rezultatet e angazhim auditimit*

### Kriteri 92.

Si të siguroheni se auditimi i brendshëm komunikon në mënyrë të qartë gjetjet dhe ndikimin e tyre.

#### Hapat e shqyrtimit

- Vlerësoni, nëse gjetjet e auditimit për çështje të rëndësishme dallohen qartë nga ato për çështje më pak të rëndësishme.
- Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm argumentojnë se çfarë ndikimi do të kenë në objektivat e njësisë publike gjetjet, nëse nuk do të adresohen çështjet e rëndësishme të identifikuara.
- Intervistoni titullarin e njësisë publike për rëndësinë e gjetjeve të auditimit.
- Vlerësoni, nëse përfundimet e auditimit janë vërtetuar dhe kanë një mesazh të qartë.

### Vlerësim



Ndikimi i gjetjeve të rëndësishme të auditimit është komunikuar në mënyrë të qartë për subjektin e audituar dhe titullarin e njësisë publike.



Auditimi i brendshëm nuk është në gjendje të bëjë dallimin midis gjetjeve të rëndësishme dhe më pak të rëndësishme. Ndikimi i gjetjeve të rëndësishme nuk është komunikuar me subjektin e audituar dhe titullarin e njësisë publike.

### Kriteri 93.



Si të siguroheni se auditimi i brendshëm pranon performancë të kënaqshme të subjekteve të audituara.

#### Hapat e shqyrtimit

- Vlerësoni, nëse audituesit e brendshëm fokusohen në dy llojet e gjetjeve pozitive dhe negative.
- Vlerësoni, nëse një opinion i kënaqshëm është i bazuar në prova të mjaftueshme.

- c. Verifikoni, nëse audituesit e brendshëm parashikojnë në mënyrë të qartë siguri pozitive ose negative.

#### **Vlerësim**

-  Raportet e auditimit paraqiten të ekuilibruar në pasqyrimin e gjetjeve pozitive dhe negative..
-  Raportet e auditimit të brendshëm fokusohen vetëm në aspektet negative.



#### **Kriteri 94.**

Si të siguroheni se raportet e auditimit të brendshëm janë të sakta, konstruktive, objektive, të qarta, koncize, të plotë dhe në kohë.

##### **Hapat e shqyrtimit**

a. Rishikoni një ose disa raporte të auditimit duke përdorur kriteret e përcaktuar të rishikimit të cilësisë.

##### **Vlerësimi**

-  Raportet e auditimit përmbushin të gjitha kriteret e përcaktuara të rishikimit të cilësisë dhe janë të sakta, konstruktive, objektive, të qarta, koncize dhe në kohë.
-  Një ose më shumë nga kriteret e përcaktuara të cilësisë mungon në raportet e auditimit të brendshëm



#### **Kriteri 95.**

Si të siguroheni se rekomandimet e auditimit janë të zbatueshme.

##### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni, nëse rekomandimet përmbajnë propozime konstruktive për të përmirësuar çështjet e identifikuara nga gjetjet e auditimit.
- b. Vlerësoni nëse rekomandimet mund të kontribuojnë për përmirësimin e veprimtarisë së njësisë publike.

##### **Vlerësimi**

-  Rekomandimet e auditimit janë të zbatueshme dhe ndihmojnë në përmirësimin e kontrolleve pa rrezikuar prioritetet e njësisë publike.
-  Rekomandimet e auditimit nuk janë të zbatueshme në praktikë, ose ato nuk adresojnë problemet që janë identifikuar.

#### **Kriteri 96.**



Si të siguroheni se reagimet e menaxhimit janë përfshirë në raportet përfundimtare të auditimit.



### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni nëse subjekteve të audituara iu është dhënë mundësia për të shprehur mendimet e tyre mbi gjetjet dhe rekomandimet e auditimit.
- b. Vlerësoni nëse mospranimi i gjetjeve (observacionet/kundërshtitë) dhe rekomandimet e auditimit janë përfshirë në raportin përfundimtar të auditimit.

### Vlerësim

-  Reagimet e menaxhimit janë përfshirë gjithmonë në raportet përfundimtare të auditimit.
-  Reagimet e menaxhimit nuk janë përfshirë në mënyrë sistematike në raportet përfundimtare të auditimit.

## Standardi - 2500 Monitorimi i Progresit

*Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të vendosë dhe mirëmbajë një proces rishikimi për të monitoruar shpërndarjen e rezultateve, të cilat i komunikohen menaxhimit,*



### Kriteri 97.

Si të siguroheni se auditimi i brendshëm monitoron veprimet e menaxhimit të subjektit të audituar në lidhje me rekomandimet e dhëna.

### Hapat e shqyrtimit

- a. Vlerësoni nëse Manuali i Auditimit të brendshëm përshkruan një proces të veçantë për monitorimin e ndjekjen nga menaxhimi të rekomandimeve të dhëna.
- b. Vlerësoni nëse NJAB ka një sistem manual ose të automatizuar për të monitoruar realizimin e rekomandimeve të auditimit.
- c. Vlerësoni nëse auditimi i brendshëm ndërmerr veprime, kur ka kaluar afati i zbatimit të rekomandimeve të dhëna.
- d. Vlerësoni nëse auditimi i brendshëm monitoron në vazhdimësi ndjekjen e rekomandimeve.

### Vlerësim

-  Auditimi brendshëm ka një proces të përcaktuar për të ndjekur veprimet e menaxhimit në lidhje me rekomandimet e auditimit.
-  Auditimi i brendshëm nuk ka një proces të përcaktuar për të monitoruar veprimet e menaxhimit në lidhje me rekomandimet e auditimit



### **Kriteri 98.**

Si të siguroheni se subjekteve të audituara iu është bërë e qartë se janë ata që mbajnë riskun dhe përgjegjësinë për zbatimin në kohë të rekomandimeve.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni nëse kjo përgjegjësi është e përcaktuar në Kartën e Auditimit të Brendshëm dhe në dokumente të tjera të ngjashme.
- b. Intervistoni një subjekt të audituar dhe vlerësoni nëse ata janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë e tyre në këtë drejtim.

#### **Vlerësim**

-  Subjektet e audituara janë plotësisht të vetëdijshëm për përgjegjësinë e tyre në lidhje me mos zbatimin e rekomandimeve të auditimit.
-  Subjektet e audituara besojnë se duhet të ndjekin rekomandimet e bëra nga auditimi i brendshëm dhe për këtë arsye ata nuk janë përfundimisht përgjegjës për risqet e zbatimit.

### **Standardi - 2600    Komunikimi i pranimit të riskut**

*Kur drejtuesi i njësisë së auditimit beson se menaxhimi i lartë ka pranuar një rrezik të mbetur i cili mund të jetë i papranueshëm për njësinë, duhet ta diskutojë këtë çështje me menaxhimin e lartë. Nëse vendimi në lidhje me rrezikun e mbetur nuk zgjidhet, drejtuesi i auditimit duhet të raportojë çështjen tek bordi për zgjidhje.*



### **Kriteri 99.**

Si të siguroheni se ka një proces të përshkallëzuar në rast se menaxhimi vendos të pranojë një nivel risku që është mbi oreksin e riskut të njësisë publike.

#### **Hapat e shqyrtimit**

- a. Vlerësoni nëse Manuali i auditimit përcakton hapat që duhet të ndërmerren nga drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm në një situatë të tillë.
- b. Vlerësoni nëse drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm zbaton hapat e përshkruara kur është e nevojshme.

#### **Vlerësim**

-  Drejtuesi i NJAB- së ndjek një proces të përshkallëzuar, kur menaxhimi pranon nivelin e riskut përtej oreksit për risk të njësisë publike.
-  Drejtuesi i NJAB- së nuk ndërmerr asnjë hap kur menaxhimi pranon nivel risku përtej oreksit për risk të njësisë publike.

## ANEKSI 2: LISTA E SHKURTIMEVE

<b>Shkurtimi</b>	<b>Emërtimi i Plotë</b>
AB	Auditimi i Brendshëm
SPHAB	Struktura Përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm
NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
IIA	Instituti (ndërkombëtar) i Audituesve të Brendshëm
ISPPIA	Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit

